



Instruksionet e  
përdorimit

Quality, Design and Innovation



[home.liebherr.com/fridge-manuals](http://home.liebherr.com/fridge-manuals)



**LIEBHERR**

# Përbajtja

<b>1</b>	<b>Pajisja në një vështrim të shpejtë.....</b>	<b>3</b>	<b>6.2.30</b>	<b>Historia e alarmeve .....</b>	<b>37</b>		
1.1	Përbajtja e dërgesës.....	3	6.2.31	Releja e alarmit .....	38		
1.2	Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve.....	3	6.2.32	Modaliteti i demonstrimit .....	39		
1.3	Pajimet e veçanta.....	3	6.2.33	Rikthimi në cilësimet nga fabrika .....	39		
1.4	Fusha e përdorimit e pajisjes.....	4	6.3	Mesazhet.....	39		
1.5	Emetimi i zhurmës nga pajisja.....	4	6.3.1	Paralajmërimet.....	39		
1.6	Konformiteti.....	4	6.3.2	Kujtesat.....	41		
1.7	Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH.....	5	<b>7</b>	<b>Pajisjet.....</b>	<b>42</b>		
<b>2</b>	<b>Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë.....</b>	5	7.1	Brava e sigurisë.....	42		
<b>3</b>	<b>Mënyra e funksionimit të ekranit Touch &amp; Swipe.</b>	7	7.2	Telekomanda.....	42		
3.1	Navigimi dhe shpjegimi i simboleve.....	7	7.3	Sensorët.....	43		
3.2	Menytë.....	8	7.4	Informacioni i sensorit .....	43		
3.3	Modaliteti i qetësisë.....	8	7.5	Ndërfaqet e lidhjes.....	43		
<b>4</b>	<b>Vënia në punë.....</b>	<b>8</b>	<b>Mirëmbajtja.....</b>	<b>44</b>			
4.1	Kushtet e instalimit.....	8	8.1	Plani i mirëmbajtjes.....	44		
4.2	Përmasat e pajisjes.....	9	8.2	Shkrirja e pajisjes.....	45		
4.3	Transportimi i pajisjes.....	9	8.3	Pastrimi i pajisjes.....	46		
4.4	Nxjerrja e pajisjes nga paketimi.....	9	8.4	Ndërrimi i baterisë së pajisjes.....	46		
4.5	Lidhja e kordonit të lidhjes elektrike.....	10	8.5	Ndërrimi i baterisë së telekomandës.....	47		
4.6	Montimi i siguresës kundër përbysjes.....	10	<b>9</b>	<b>Ndihma për klientin.....</b>	<b>47</b>		
4.7	Instalimi i pajisjes.....	10	9.1	Të dhënat teknike.....	47		
4.8	Instalimi i disa pajisjeve.....	11	9.2	Defektet teknike.....	48		
4.9	Pas instalimit.....	11	9.3	Shërbimi për klientin.....	49		
4.10	Hedhja e paketimit.....	11	9.4	Etiketa e parametrave.....	49		
4.11	Ndërrimi i krahut të hapjes së derës.....	11	<b>10</b>	<b>Nxjerra jashtë pune.....</b>	<b>49</b>		
4.12	Nivelimi i derës.....	16	<b>11</b>	<b>Hedhja/asgjësimi.....</b>	<b>49</b>		
4.13	Lidhja e pajisjes.....	16	11.1	Përgatitja e pajisjes për asgjësimin.....	49		
4.14	Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë).....	17	11.2	Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike.....	49		
4.15	Vendosja e pjesëve.....	18	<b>12</b>	<b>Informacionet shtesë.....</b>	<b>50</b>		
4.16	Rafti i ndërmjetëm me rrjetë.....	18	<b>13</b>	<b>Udhëzuesi i shkurtër për përdorimin e përditshëm.....</b>	<b>51</b>		
<b>5</b>	<b>Ruajtja.....</b>	<b>18</b>	Prodhuesi punon në vazhdimësi për zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha llojeve dhe modeleve. Për këtë arsy, lutemi në mirëkuptimin tuaj që ne duhet të rezervojmë të drejtën e ndryshimeve në formë, pajisje dhe teknologji.				
5.1	Udhëzime për ruajtjen.....	18	<b>Simboli</b>	<b>Shpjegimi</b>			
<b>6</b>	<b>Përdorimi.....</b>	<b>18</b>					
6.1	Elementet e komandimit dhe tregues.....	18					
6.1.1	Treguesi i statusit.....	19					
6.1.2	Simbolet treguese.....	19					
6.1.3	Sinjalet akustike.....	20					
6.2	Funksionet e pajisjes.....	20					
6.2.1	Udhëzime për funksionet e pajisjes.....	20					
6.2.2	Ndezja dhe fikja e pajisjes .....	20					
6.2.3	Temperatura .....	20					
6.2.4	Regjistrimi i temperaturave .....	21					
6.2.5	Ndriçimi .....	21					
6.2.6	Blllokimi i derës .....	21					
6.2.7	SmartLock.....	23					
6.2.8	Siguria e aksesit në mënyrë Cilësimet .....	24					
6.2.9	Kodet e aksesit.....	25					
6.2.10	Telekomanda .....	28					
6.2.11	Kujtesa e intervalit të mirëmbajtjes .....	28					
6.2.12	Gjuha .....	29					
6.2.13	Data dhe ora .....	29					
6.2.14	Njësia e temperaturës .....	29					
6.2.15	Niveli i drithës së ekranit .....	29					
6.2.16	Alarm Sound.....	30					
6.2.17	Key Sound.....	30					
6.2.18	Lidhja e WLAN .....	30					
6.2.19	Lidhja e LAN .....	32					
6.2.20	Informacioni i pajisjes .....	33					
6.2.21	Orët e punës .....	33					
6.2.22	Software .....	33					
6.2.23	Shkrirja .....	33					
6.2.24	Shkarkimi i të dhënave / Datalogging.....	34					
6.2.25	Kalibrimi i sensorit .....	34					
6.2.26	Alarmi i temperaturës .....	35					
6.2.27	Alarmi i derës .....	36					
6.2.28	Alarmi me drithë .....	36					
6.2.29	Simulimi i alarmeve .....	37					


	<b>Lexoni manualin e instruksioneve</b> Për t'u njojur me të gjitha avantazhet e pajisjes suaj të re, ku lutemi të lexoni me kujdes udhëzimet në këtë manual instruksionesh.
	<b>Informacionet plotësuese në internet</b> Manualin dixhital me informacionet plotësuese dhe në gjuhë të tjera e gjeni në internet nëpërmjet kodit QR në kopertinën e këtij manuali ose duke futur numrin e servisit në adresën <a href="http://home.liebherr.com/fridge-manuals">home.liebherr.com/fridge-manuals</a> . Numrin e servisit e gjeni në etiketën e parametrave: 
	<b>Kontrolli i pajisjes</b> Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te kujdesi për klientin.

Fig. Shembull ilustrues

Simboli	Shpjegimi
	<b>Ndryshimet</b> Manuali është i vlefshëm për disa modele, kështu që mund të ketë ndryshime. Seksionet që kanë të bëjnë vetëm me pajisje të caktuara janë të shënuara me një yll (*).
	<b>Udhëzimet e veprimeve dhe rezultatet e veprimeve</b> Udhëzimet e veprimeve janë të shënuara me një ▶. Rezultatet e veprimeve janë të shënuara me një ▷.
	<b>Videot</b> Videot për pajisjet ofrohen në kanalin në YouTube të kompanisë Liebherr-Hausgeräte.

Këto instrukSIONE përdorimi vlejnë për:

- SFPvh 1402
- SFPvh 6501
- SFPvh 8401

## 1 Pajisja në një vështrim të shpejtë

### 1.1 Përbajtja e dërgesës

Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te kujdesi për klientin. (shihni 9.3 Shërbimi për klientin)

Dërgesa përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

- Pajisja me qëndrim të pavarur
- Pajisjet \*
- Materiali i montimit \*
- Instruksionet e përdorimit
- Brosura e shërbimit
- Certifikata e cilësisë \*
- Kordoni elektrik
- Pulti i komandimit
- Çelësi i zhbllokimit të emergjencës
- Kompleti i mbërthimit në mur

### 1.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve

SFPvh 1402

SFPvh 6501

SFPvh 8401




Fig. 1 Shembull ilustrues

- (1) Etiketa e parametrave
- (2) Raftet me rrjetë
- (3) Rrotat
- (4) Brava
- (5) Elementët e komandimit dhe treguesi i temperaturës
- (6) Vrima e shkarkimit për ujin e pastrimit
- (7) Ndriçimi i brendshëm \*
- (8) Sensori P
- (9) Vrima e depërtimit e sensorit

**SFPvh 1402**




Fig. 2 Shembull ilustrues

- (1) Etiketa e parametrave
- (6) Vrima e shkarkimit për ujin e pastrimit

# Pajisja në një vështrim të shpejtë

- |  |                                   |
|--|-----------------------------------|
| (2) Raftet me rrjetë                                   | (7) Ndriçimi i brendshëm *        |
| (3) Rrotat   | (8) Sensori P                     |
| (4) Brava  | (9) Vrima e depërtimit e sensorit |
| (5) Elementët e komandimit dhe treguesi i temperaturës | (10) Rafti i ndërmjetëm me rrjetë |




Fig. 3 Shembull ilustrues

- |                                |   |
|--------------------------------|---|
| (1) Lidhja për sensorin P      | (3) Dalja e alarmit me kontakt pa potencial |
| (2) Ndërfaqja e lidhjes së USB | (4) Ndërfaqja e lidhjes së rrjetit LAN      |

## 1.3 Pajimet e veçanta

### Shënim

Aksesorët mund t'i blini te kujdesi për klientin (shihni 9.3 Shërbimi për klientin) dhe në dyqanin Liebherr-Hausgeräte në adresën e interneti [home.liebherr.com/shop/de/deu/zubehor.html](http://home.liebherr.com/shop/de/deu/zubehor.html).

### SmartModule

Pajisja është e pajisur me një SmartModule.

Ky vepron si një ndërfaqe lidhëse WLAN dhe LAN për të krijuar lidhjen midis pajisjes dhe një sistemi të jashtëm dokumentimi dhe alarmi, si për shembull Liebherr SmartMonitoring.

Liebherr SmartMonitoring Dashboard nuk ofrohet në të gjitha shtetet. Kontrolloni disponueshmërinë e tij përmes kodit QR (shihni 6.2.18 Lidhja e WLAN ) duke futur modelin tuaj.

### Pajisja plotësuese me sirtarë

Në rastin e pajisjes plotësuese me sisteme sirtarësh në frigoriferët ftohës dhe ngrirës Liebherr që përdoren përuajtjen e materialeve të ndjeshme ndaj temperaturave, të tillë si medikamentet që kanë nevojë përfshirje dhe produktet e tjera në ftohje dhe që u nënshtrohen kërkese standarde të veçanta, nevojitet një kualifikim i temperaturës. Pajisja plotësuese me sirtarë në frigoriferët ftohës dhe ngrirës Liebherr mund të rezultojë në prishjen e produkteve në ruajtje ose në dëmtim të produkteve në ruajtje. Për këtë arsy, pajisja plotësuese duhet realizuar vetëm nga ofruesi i autorizuar i shërbimit, i prodhuesit të frigoriferit ftohës/ngrirës.

## 1.4 Fusha e përdorimit e pajisjes

### Përdorimi i parashikuar

Ky frigorifer ngrirës për laboratorët është i përshtatshëm për ruajtjen profesionale të produkteve në temperaturë midis -9 °C dhe -35 °C.

Produktet tipike për ruajtje janë provat e kërkimeve, reagentët, inventari i laboratorit e të tjera.

Pajisja është përmbush specifikimet e standardit DIN 13277 - Frigoriferët ftohës dhe ngrirës për përdorime laboratorike dhe mjekësore.

Ruajtja e substancave të ndjeshme ndaj temperaturës, kërkon përdorimin e një sistemi të pavarur alarmi me monitorim të pérhershëm. Ky sistem alarmi duhet të jetë i projektuar në mënyrë të tillë që çdo gjendje alarmi të regjistrohet nga një person përgjegjës, në mënyrë që të merren masat përkatëse.

### Përdorimi i gabuar i parashikueshëm

Mos e përdorni pajisjen për përdorimet e mëposhtme:

- Ruajtja dhe ftohja e:

- substancave kimike të paqëndrueshme, që marrin flakë ose irrituese
- gjakut, plazmës ose e lëngjeve të tjera të trupit, për qëllimet e infuzionit, të aplikimit ose të futjes në trupin e njeriut.
- Përdorimi në ambiente potencialisht shpërthyese.
- Përdorimi në ambient të jashtëm ose në vende me lagështi dhe ku spërkatet nga uji.
- Përdorimi në ambient banimi, sepse në këto mjedise nuk mund të garantohet mbrojtja e përshtatshme kundër marrjes së radio valëve.\*

Përdorimi i gabuar i pajisjes çon në dëmtim ose prishje të artikujve të vendosur në ruajtje.

### Klasat e klimës

Klasa përkatëse e klimës për pajisjen tuaj është e stampuar në etiketën e parametrave.




Fig. 4 Etiketa e parametrave

(X) Kjo klasë e klimës tregon se në cilat kushte të ambientit pajisja mund të përdoret në mënyrë të sigurt.

Klasa e klimës (X)	Temperatura maks. ambientit	Lagështia maks. relative e ajrit
7	35 °C	75%

## Shënim

Temperatura minimale e lejuar e ambientit në vendin e instalimit është 10 °C.

Në kushtet kufi të funksionimit, në xhamin e derës (në varësi të pajisjes) dhe në faqet anësore mund të krijohet një kondensim i lehtë.

## 1.5 Emetimi i zhurmës nga pajisja

Niveli i matur i emetimit të presionit të tingullit A gjatë punës së pajisjes është nën 70 dB(A) (fufqia e tingullit në lidhje me 1 pW).

## 1.6 Konformiteti

Qarku i gazit ftohës është testuar përrnjedhje. Pajisja është në përputhje me dispozitat përkatëse të sigurisë.

### Deklarata EU e konformitetit

Prodhuesi/Lëshuesi:	LIEBHERR-HAUSGERÄTE LIENZ GMBH
Adresa:	A-9900 Lienz, Dr. Hans Liebherr Straße 1
Produkti i përcaktuar është në përputhje me rregullat e direktivave dhe rregulloreve evropiane më poshtë:	
(BE) 2019/2020, 2014/35/BE, 2014/30/BE, 2011/65/BE	
Moduli i integruar me valë është në përputhje me Direktivën 2014/53/BE. Informacionet përmodulin me valë (shihni 9.1 Të dhënat teknike).	
Teksti i plotë i deklaratës EU të konformitetit disponohet në adresën e mëposhtme të internetit: <a href="http://www.liebherr.com">www.liebherr.com</a>	

## 1.7 Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH

Në lidhjen nën vijim mund të kontrolloni nëse pajisja juaj përbën substancë SVHC, në kuptim të rregullores REACH: [home.liebherr.com/de/deu/de/liebherr-erleben/nachhaltigkeit/umwelt/scip/scip.html](http://home.liebherr.com/de/deu/de/liebherr-erleben/nachhaltigkeit/umwelt/scip/scip.html)

## 2 Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë

Ruani me kujdes këto instruksione përdorimi dhe dorëzojani ato, sipas rastit, edhe pronarit pasardhës.

Nëse do t'i jepni këtë pajisje dikujt tjetër, atëherë dorëzojani instruksionet e përdorimit edhe pronarit pasardhës.

Për ta përdorur pajisjen në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, lexoni me kujdes këto instruksione përdorimi përpara përdorimit të pajisjes. Ndiqni gjithmonë instruksionet që ato përbajnë, udhëzimet e sigurisë dhe udhëzimet paralajmëruese. Ato janë të rëndësishme, në mënyrë që ta instaloni dhe ta përdorni pajisjen në mënyrë të sigurt dhe të saktë.

## Reziqet për përdoruesin:

- Kjo pajisje lejohet të përdoret vetëm nga personeli teknik dhe i laboratorit, i cili është trajnuar për këtë qëllim dhe që është i familjarizuar me të gjitha masat e sigurisë për punën në një laborator. Nuk lejohet që kjo pajisje të vihet në punë apo të përdoret nga fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore apo që kanë mungesë përvoste dhe njojurish.
- Priza elektrike duhet të jetë lehtësisht e arritshme, në mënyrë që pajisja të shkëputet shpejt nga energjia elektrike në rast emergjencë. Ajo duhet të ndodhet jashtë zonës së pjesës së pasme të pajisjes.
- Kur pajisja shkëputet nga rrjeti elektrik, kapeni gjithmonë nga spina. Mos e tërhiqni nga kablloja.
- Në rast defekti hiqni spinën elektrike nga priza ose fikni siguresën.
- **PARALAJMËRIM:** Mos dëmtoni kordonin e lidhjes elektrike. Mos e vini në punë pajisjen me kordon elektrik të dëmtuar.
- **PARALAJMËRIM:** Prizat bashkuese me kabllo/me shumë spina dhe pajisjet e tjera elektronike (si për shembull transformatori i ndriçimit halogjen) nuk duhen vendosur dhe të punojnë në anën e pasme të pajisjeve.
- **PARALAJMËRIM:** Mos mbyllni vrimat e ajrimit në trupin e pajisjes ose në folenë e montimit.
- Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje lejohen të kryhet vetëm nga kujdesi për klientin ose nga staf tjetër teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- Montoni, lidhni dhe hidhni pajisjen vetëm sipas specifikimeve në manualin e instruksioneve.

## Rrezik zjarri:

- Gazi ftohës i pajisjes (specifikimet në etiketten e parametrave) është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës që rrjedh mund të marrë flakë.
  - **PARALAJMËRIM:** Mos dëmtoni qarkun e ftohjes.
  - Mos përdorni burime ndezjeje në brendësi të pajisjes.
- **PARALAJMËRIM:** Mos vendosni në punë asnjë pajisje elektrike brenda ndarjes së ftohjes, të cilat nuk përputhen me

# Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë

mënyrën e ndërtimit të rekomanduar nga prodhuesi.

- Nëse ka rrjedhje të gazit ftohës: Mënjanoni flakën e zbuluar ose burimet e ndezjes në afërsi të vendit të rrjedhjes. Ajrosni mirë dhomën. Njoftoni kujdesin për klientin.
- Mos e vini në punë pajisjen në afërsi të gazeve shpërthyese.
- Mos ruani ose mos përdorni në afërsi të pajisjes benzinë apo gaze dhe lëngje të tjera të djegshme.
- Mos ruani në pajisje lëndë me aftësi shpërthyese, si për shembull kanaçe aerosol me gaz shtytës të djegshëm. Kanaçet spërkatëse përkatëse identifikohen tek të dhënat e printuara të përbajtjes ose nga një simbol flake. Gazet që mund të kenë rrjedhur mund të ndizen nga pjesët elektrike.
- Mbani larg nga pajisja qirinjtë e ndezur, llambat ose objektet e tjera me flakë të zbuluar, në mënyrë që këto të mos i vënë flakën pajisjes.
- Lëngjet alkoolike ose paketimet e tjera që përbajnë alkool vendosini në ruajtje të mbyllura në mënyrë hermetike. Alkooli që mund të kenë rrjedhur mund të ndizet nga pjesët elektrike.

## Rreziku i pengimit dhe përbysjes:

- **PARALAJMËRIM:** Për të shhangur rrezikun për shkak të paqëndrueshmërisë së pajisjes, duhet që ajo të mbërthehet sipas instrukSIONEVE.
- Mos i përdorni bazamentin, sirtarët, dyert etj. si shkallë ose si vend për t'u mbështetur.

## Rreziku i morthit, i ndjesisë së ngrirjes dhe dhimbjeve:

- Shhangni kontaktin e zgjatur të lëkurës me sipërfaqet e ftohta ose artikujt në ftohje/artikujt në ngrirje ose merrni masa mbrojtëse, si p.sh. përdorimi i dorezave.

## Rreziku i lëndimit dhe dëmtimit:

- **PARALAJMËRIM:** Për të shpejtuar procesin e shkrirjes mos përdorni asnjë pajisje tjetër mekanike ose ndonjë mënyrë tjetër përvëç atyre të rekomanduara nga prodhuesi.
- **PARALAJMËRIM:** Rrezik lëndimi nga goditja elektrike! Nën kapakun mbulues ndodhen pjesë që përçojnë energji elektrike. Ndriçimi i brendshëm LED duhet ndërruar ose riparuar vetëm nga kujdesi për klientin

ose nga staf teknik i trajnuar për këtë gjëllim.

**KUJDES:** Pajisja lejohet të vihet në punë vetëm me aksesorë origjinalë nga prodhuesi i saj ose me aksesorë të ofruesve të tjerë të miratuar nga prodhuesi i pajisjes. Përdoruesi e merr vetë përsipër rrezikun e përdorimit të aksesorëve të pamiratuar.

## Rreziku i shtypjes:

- Mos i futni duart te mentesha gjatë hapjes dhe mbylljes së derës. Gishtat mund të kafen aty.

## Kualifikimi i stafit teknik:

Pajisja lejohet të instalohet, të testohet, të mirëmbahet dhe të vihet në funksionim vetëm nga stafi teknik që është i familjarizuar me montimin, vënien në punë dhe përdorimin e pajisjes.

Staf teknik janë personat që si rezultat i formimit, të njohurive dhe të përvojës së tyre teknike dhe të njohjes së standardeve përkatëse, janë të gjendje të vlerësojnë dhe të realizojnë punën që u është caktuar atyre, si dhe të identifikojnë rreziqet e mundshme. Ju duhet të keni një trajnim, udhëzim dhe autorizim për të punuar në pajisje.

## Simbolet në pajisje:


Simboli mund të gjendet mbi kompresor. Ai ka të bëjë me vajin në kompresor dhe jep udhëzim për rrezikun e mëposhtëm:



**Mund të jetë fatal në rast gëlltitjeje ose futjeje në rrugët e frysma Marrjes.** Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Në gjendje pune normale nuk ekziston asnjë rrezik.




**PARALAJMËRIM:** Rrezik zjarri / materiale të ndezshme. Simboli ndodhet në kompresor dhe identifikon rrezikun nga lëndët me rrezik ndezjeje. Mos e hiqni etiketën ngjitetëse.



Simboli ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes në zonë e relesë së alarmit dhe tregon rrezikun e mëposhtëm: **Goditje elektrike!** Edhe kur pajisja është e shkëputur nga rrjeti elektrik, mund të ketë ende tension elektrik të mabetur. Mos e hiqni etiketën ngjitetëse.



Kjo etiketë ngjitetëse ose një etiketë e ngjashme mund të ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes. Ajo tregon se te dera dhe/ose tek trupi ka panele izoluese me vakuum (VIP) ose panele me perlit. Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Mos e hiqni etiketën ngjitetëse.



Kjo etiketë ngjitëse ose një etiketë e ngjashme mund të ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes. Ajo i referohet baterisë së integruar Li-ion. Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Mos e higni etiketenq nqjitetë.



**PARALAJMËRIM: Sipërfaqe e ftohtë!** Prekni vetëm me doreza të përshtatshme.

Kjo etiketë ngjitëse ose një etiketë e ngjashme mund të ndodhet në pajisje dhe këshillon për rrezikun e ngririeve.

Ndiqni udhëzimet paralajmëruese dhe udhëzimet e tjera specifike në kapitujt e tierë:

	<b>RREZIK</b>	Identifikon një situatë të rrezikshme të drejtpërdrejtë, e cila ka si pasojë vdekjen ose lëndime të rënda fizike, nëse nuk mënjanohet.
	<b>PARALAJMËRIM</b>	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë vdekjen ose lëndimin e rëndë fizik, nëse nuk mënjanohet.
	<b>VINI RE</b>	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë lëndime fizike të lehta ose mesatare, nëse nuk mënjanohet.
	<b>KUJDES</b>	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë dëme materiale, nëse nuk mënjanohet.
	<b>Shënim</b>	Identifikon udhëzimet dhe këshillat e dobishme.

Simboli	Përshkrimi
	<b>Prekja e gjatë e ekranit me kohën e specifikuar (p.sh. 3 sekonda):</b> Aktivizoni/çaktivizoni funksionin ose vlerën.
	<b>Rrëshqitja e gishtit djathtas ose majtas:</b> Navigoni nëpër meny.
	<b>Prekja shkurt e simbolit të kthimit prapa:</b> Ktheheni pas me një nivel të menysë.
	<b>Mbajtja prekur e simbolit të kthimit prapa për 3 sekonda:</b> Ktheheni pas tek treguesi i statusit.
	<b>Prekja shkurt e simbolit të kthimit prapa majtas lart:</b> Ktheheni pas me një nivel të menysë.
	<b>Shigjeta me orën:</b> Nevojiten më shumë se 10 sekonda derisa në ekran të shfaqet treguesi pasardhës.
	<b>Shigjeta me specifikimin e kohës:</b> Do të kalojë koha e treguar derisa në ekran të shfaqet treguesi pasardhës.
	<b>Hapja e simbolit "Menja Cilësimet":</b> Navigoni për në menynë e cilësimeve dhe hapni menynë e cilësimive. Nëse nevojitet: Në menynë e cilësimeve navigoni për në funksionin që dëshironi. (shihni 3.2.1 Hapja e menysë Cilësimet)
	<b>Hapja e simbolit "Menja e zgjeruar":</b> Navigoni për në menynë e zgjeruar dhe hapni menynë e zgjeruar. Nëse nevojitet: Në menynë e zgjeruar navigoni për në funksionin që dëshironi. (shihni 3.2.2 Hapja e menysë së zgjeruar)
Asnjë veprim brenda 10 sekondave	Nëse për 10 sekonda nuk kryeni asnjë veprim në ekran, treguesi i ekranit kthehet ose te menja e një nivelit më lart, ose kthehet direkt tek treguesi i statusit.
Hapja dhe mbyllja përsëri e derës.	Nëse e hapni derën dhe e mbyllni përsëri menjëherë, treguesi kthehet direkt tek treguesi i statusit.

*Shënim: Figurat e ekranit paraqiten me termat në gjuhën angleze.*

### 3.1 Navigimi dhe shpiegimi i simboleve

Në figura përdoren simbole të ndryshme për navigimin në ekran. Këto simbole përshtohen në tabelën në vijim.

Simboli	Përshkrimi
	<p><b>Prekja e shkurtër e ekranit:</b>            Aktivizoni/çaktivizoni funksionin.            Konfirmoni përzgjedhjen.            Hapni nënmenynë.</p>

### 3.2 Menyt 

## 3.2 Menytö

Funksionet e pajisjes janë të ndara në meny të ndryshme:

# Venia në punë

Menja	Përshkrimi
Menja kryesore	Kur ndizni pajisjen, atëherë ndodheni automatikisht në menynë kryesore. Nga këtu, ju navigoni për në funksionet më të rëndësishme të pajisjes, në menynë e cilësimeve dhe në menynë e zgjeruar.
 Settings Menja Cilësimet	Menja Cilësimet përmban funksione të tjera të pajisjes, për rregullimin e pajisjes suaj.
 HCM Menja e zgjeruar	Menja e zgjeruar përmban funksionet e veçanta të pajisjes, për rregullimin e pajisjes suaj. Hyrja në menynë e zgjeruar është e mbrojtur përmes kodit me numra <b>151</b> .

## 3.2.1 Hapja e menysë Cilësimet




Fig. 5 Shembull ilustrues

- Kryeni hapat e vepprimeve siç tregohet në figurë.
- Hapet menja Cilësimet.
- Nëse nevojitet: Navigoni për në funksionin që dëshironi.

## 3.2.2 Hapja e menysë së zgjeruar




Fig. 6 Hyrja me kodin me numra **151**

- Kryeni hapat e vepprimeve siç tregohet në figurë.
- Hapet menja e zgjeruar.
- Nëse nevojitet: Navigoni për në funksionin që dëshironi.

## 3.3 Modaliteti i qetësisë

Nëse nuk e prekni ekranin për 1 minutë, atëherë ekranin kalon në modalitetin e qetësisë. Në modalitetin e qetësisë, niveli i dritës së treguesit është i errësuar.

### 3.3.1 Përfundimi i modalitetit të qetësisë

- Prekni shkurt ekranin me gisht.
- Modaliteti i qetësisë përfundon.

# 4 Venia në punë

## 4.1 Kushtet e instalimit



### PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri nga lagështia!

Kur pjesët përcuese të energjisë elektrike ose kordoni i lidhjes elektrike lagen, kjo mund të shkaktojë lidhje të shkurtër.

- Pajisja është projektuar për përdorim në ambiente të myllura. Mos e vini në punë pajisjen në ambiente që jashtëm dhe në vende ku spërkatet nga uji.

### 4.1.1 Vendi i instalimit



### PARALAJMËRIM

Gaz ftohës dhe vaj që del jashtë!

Zjarr. Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rrjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkates dhe në kontakt me një burim nxehësie të jashtëm.

- Mos dëmtoni tubacionet e qarkut të gazit ftohës dhe kompresorin.

- Mos e instaloni pajisjen në një vend në rrezet direkte të diellit, pranë sobës, sistemit të ngrohjes dhe të ngjashme.
- Vendi optimal i instalimit është një vend i thatë dhe me ajrosje të mirë.
- Kur pajisja instalohet në një ambient me shumë lagështi, në anët e jashtme të pajisjes mund të formohet ujë nga kondensimi.  
Kujdesuni gjithmonë për qarkullimin e mirë të ajrit dhe për ajrimin e mirë në vendin e instalimit.
- Sa më shumë gaz ftohës të ketë në pajisje, aq më e madhe duhet të jetë dhoma ku qëndron pajisja. Në dhomat shumë të vogla mund të krijohet përzierje e ndezshme gaz-ajër, në rast rrjedhjeje të gazit. Dhoma e instalimit duhet të ketë një vëllim minimumi  $1\text{ m}^3$  për çdo 8 g gaz ftohës. Specifikimet për gzin ftohës të pajisjes jepen në etiketten e parametrave, në hapësirën e brendshme të pajisjes.
- Dyshemëja në vendin e qëndrimit duhet të jetë e drejtë dhe e niveluar.
- Vendi i instalimit duhet të ketë kapacitet mbajtës për peshën e pajisjes, duke përfshirë edhe sasinë maksimale të ruajtjes brenda saj. (shihni 9.1 Të dhënat teknike)
- Nuk lejohet përdorimi në ambiente potencialisht shpërthyese.

#### 4.1.2 Lidhja elektrike



##### PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri nga instalimi i pasaktë!

Kur një kordon elektrik ose spinë prek pjesën e pasme e pajisjes, ekziston mundësia që dridhet e pajisjes të dëmtojnë kordonin elektrik ose spinën dhe në këtë mënyrë të shkaktohet lidhje e shkurtër.

- Bëni kujdes që kur të instaloni pajisjen të mos bllokoni asnje kordon elektrik poshtë pajisjes.
- Instalojeni pajisjen në mënyrë të tillë që të mos prekë me asnje spinë ose kordon elektrik.
- Mos lidhni pajisje të tjera në priza elektrike që ndodhen pas pjesës së pasme të pajisjes.
- **Mos** vendosni dhe mos përdorni priza me disa dalje ose priza bashkuese me shumë priza dhe pajisje të tjera elektronike (si për shembull transformatori i ndriçimit halogjen) në anën e pasme të pajisjeve.

#### 4.2 Përmasat e pajisjes




Fig. 7 Shembull ilustrues




Fig. 8 Shembull ilustrues

	SFPvh 1402	SFPvh 6501
E	1532 mm	1532 mm

	SFPvh 8401
A	2135 mm
B	787 mm
C	1017 mm
D	1740 mm
E	1772 mm

A = Lartësia e pajisjes përfshirë këmbët (në minimum) / rrotat

B = Gjerësia e pajisjes pa dorezën

C = Thellësia e pajisjes pa dorezën

D = Thellësia e pajisjes me derën e hapur

E = Thellësia e pajisjes me zgjatimin e dorezës dhe mbrojtjen kundër përbysjes

#### 4.3 Transportimi i pajisjes



##### RREZIK

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga pajisja e rëndë!

- Transportoni pajisjen gjithmonë me të paktën dy persona.



##### RREZIK

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga përbysja e pajisjes!

- Bëni kujdes gjatë transportit të pajisjeve në dysheme jo të niveluara dhe në rampa.

##### Gjatë transportit të pajisjes mban parasysh:

- Transportojeni pajisjen vertikalisht.
- Nëse nevojitet: Çmontoni pajisjet me dy dyer për t'i transportuar.

##### Në vënien në punë herën e parë:

- Transportojeni pajisjen brenda paketimit.

##### Gjatë transportit të pajisjes pas vënies në punë herën e parë (p. sh. transferim ose pastrim):

- Zbrazni pajisjen.
- Siguroni derën kundër hapjes së paqëllimshme.

#### 4.4 Nxjerra e pajisjes nga paketimi

- Kontrolloni pajisjen dhe paketimin e saj për dëmtime nga transporti. Kontaktoni menjëherë me furnizuesin nëse konstatoni ndonjë dëmtim. Mos e lidhni pajisjen në linjën e furnizimit me energji elektrike.
- Largoni të gjitha materialet e paketimit nga faqja e pasme ose nga faqet anësore të pajisjes, të cilat mund të pengojnë instalimin në mënyrën e duhur ose qarkullimin e ajrit dhe ventilimin.

	SFPvh 1402	SFPvh 6501
A	2135 mm	2135 mm
B	1427 mm	697 mm
C	867 mm	867 mm
D	1500 mm	1500 mm

## 4.5 Lidhja e kordonit të lidhjes elektrike




Fig. 9

- ▶ Futni spinën e pajisjes ftohëse të kordonit të lidhjes elektrike Fig. 9 (1) në pjesën e pasme të pajisjes.
- ▶ Montoni fiksuesin e kabllos. Fig. 9 (2)




Fig. 12

- ▶ Vendosni shenjat në mur.
- ▶ Largoni pajisjen.

## 4.6 Montimi i siguresës kundër përbrysjes



### PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga përbrysja e pajisjes!

Rrezik për jetën dhe për dëme materiale në pajisje. Kur nxirri jashtë nga pajisja raftet e ngarkuara plot, pajisja mund të përbryset.

- ▶ Përpresa se të vini pajisjen në punë: Montoni gjithmonë siguresën kundër përbrysjes në përputhje me instrukzionet.




Fig. 10

Siguresa kundër përbrysjes gjenden brenda në pajisje. Ajo përbëhet nga pjesa mbajtëse, një hekur, tetë rondela dhe tetë dado.




Fig. 11

- ▶ Montoni hekurin në pajisje me dadot dhe vidat e ofruara.
- ▶ Shtyni pas murit pajisjen me pjesët mbajtëse të montuara.
- ▶ Niveloni pajisjen.




Fig. 13

Në varësi të karakteristikave të faqes së murit ose të dyshemesë (dru, beton), përdorni materialet e përshtatshme të fiksimit (p.sh. upa) dhe pika fiksimi të mjaftueshme.

- ▶ Mbërtheni grepat e sigurisë.

## 4.7 Instalimi i pajisjes



### VINI RE

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi!

- ▶ Instalonit pajisjen me 2 persona.



### VINI RE

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi!

Dera mund të përplaset në mur dhe për pasojë të dëmtohet. Në dyert me xham, xhami i dëmtuar mund të shkaktojë lëndime!

- ▶ Mbroni derën nga përplasia në mur. Vendosni në mur ndalues dere, për shembull ndalues prej shajaku.
- ▶ Lidhni të gjitha pjesët e nevojshme (p.sh. kordoni elektrik) në pjesën e pasme të pajisjes dhe nxirri ato anash.

### Shënim

Kabllot mund të dëmtohen!

- ▶ Mos e kapni kabllon gjatë shtyrjes prapa të pajisjes.

- ▶ Shtyjeni pajisjen pas murit në mënyrë të tillë që pjesët mbajtëse të futen në grepat e sigurisë.
- ▶ Tani pajisja është e sigurt kundërt përbrysjes.

- Ajo mund të lirohet përsëri duke ngritur lart grepat e sigurisë.
- Distanca midis buzës së sipërme të pajisjes dhe tavanit të dhomës duhet të jetë minimumi 300 mm.

## 4.8 Instalimi i disa pajisjeve

### KUJDES

Rrezik dëmtimi nga uji i kondensimit midis faqeve anësore!

- Mos e instaloni pajisjen direkt njitur me një pajisje tjetër ftohëse.
- Instaloni pajisjet me një distancë 3 cm midis pajisjeve.
- Instaloni pranë njëra-tjetrës disa pajisje vetëm deri në temperaturë prej 35 °C dhe lagështi ajri 65%.
- Në rast lagështie më të lartë të ajrit, rritni distancën midis pajisjeve.




Fig. 14 Instalimi Side-by-Side

### Shënim

Një komplet për instalimin Side-by-Side mund të blihet si aksesor te shërbimi për klientin i Liebherr. (shihni 9.3 Shërbimi për klientin)

## 4.9 Pas instalimit

- Hiqni fletën mbrojtëse.\*
- Pastroni pajisjen. (shihni 8.3 Pastrimi i pajisjes)
- Nëse nevojitet: Dezinfektoni pajisjen.
- Ruani faturën dhe në rastin e nevojës për shërbim mbani në dispozicion të dhënat e pajisjes dhe të shitësit.

## 4.10 Hedhja e paketimit



### PARALAJMËRIM

Rrezik mytjeje nga materiali i paketimit dhe fletë mbështjellëse!

- Mos lejoni fëmijët të luajnë me materialet e paketimit.

Paketimi është i prodhuar nga materiale të ripërdorshme:

- Karton i valëzuar/karton
- Pjesë nga polistiroli i shkumëzuar
- Fletë mbështjellëse dhe qeska prej polietileni
- Shirita prej polipropileni
- Kornizë druri i mbërthyer me gozhda, me shtresa prej polietileni\*
- Dërgoni materialin e paketimit në një pikë të autorizuar grumbullimi.

## 4.11 Ndërrimi i krahut të hapjes së derës

### 4.11.1 Udhëzimet e sigurisë



### PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi nga ndërrimi jo profesional i krahut të hapjes së derës!

- Kryeni ndërrimin e krahut të hapjes së derës vetëm nga stafi teknik.



### PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi dhe dëmesh materiale nga pesha e madhe e derës!

- Kryejeni konvertimin vetëm nëse mund të mban një peshë prej 45 kg.
- Kryeni konvertimin vetëm në praninë e dy personave.

### KUJDES

Pjesë që përcojnë energji elektrike!

Dëmtim i pjesëve elektrike.

- Hiqni spinën elektrike nga priza përparrë se të kryeni ndërrimin e krahut të hapjes së derës.

### 4.11.2 Veglat e punës



### 4.11.3 Hapja e kapakut mbulues të aggregatit

- Hapni derën.




Fig. 15

- Hiqni vidat.




Fig. 16

- Ngrini për lart kapakun mbulues të aggregatit.
- Mbani të palëvizur kapakun mbulues.
- ose-




Fig. 17

- Fiksoni kapakun mbulues.

## 4.11.4 Çmontimi i derës

### 4.11.4 Çmontimi i derës (derë me shkumë)




Fig. 18

- Hiqni vidat.




Fig. 19

- Lironi vidën.




Fig. 20

- Ngrini derën paksa lart Fig. 20 (1), têrhiqeni nga përparrë në pjesën poshtë Fig. 20 (2) dhe uleni poshtë Fig. 20 (3).
- Vendoseni derën mbi një sipërfaqe të butë.
- ▷ Dera me shkumë çmontohet.

## 4.11.5 Konvertimi i sistemit të poshtëm të mbylljes




Fig. 21

- Nxirri nga dera profilin e menteshës poshtë.

### KUJDES

Rrezik lëndimi nga susta e ngjeshur!

- Mos e zërtheni sistemin e mbylljes së derës Fig. 22 (1).




Fig. 22

- Rrotulloni sistemin e mbylljes Fig. 22 (2) derisa të kërcasë.
- ▷ Tendosja paraprake e sistemit të mbylljes lirohet.




Fig. 23 Hapja djathtas

- Lironi dadon.

## Shënim

Renditja e gabuar e rondelave të rregullimit të lartësisë.

Shtrëngimi i dades nuk është më i mundur mjaftueshëm.

- Rondela duhet të futet në pjesën e poshtme të sistemit të mbylljes.




Fig. 24




Fig. 25 Hapja majtas

- Vendosni sërisht në pozicion sistemin e mbylljes dhe mbërthejeni; bëni kujdes për drejtimin e sistemit të mbylljes.
- Sistemi i poshtëm i mbylljes konvertohet.

## 4.11.6 Konvertimi i sistemit të sipërm të mbylljes

### 4.11.6 Konvertimi i sistemit të sipërm të mbylljes (derë me shkumë)




Fig. 26

- Hiqni kapakun mbulues.




Fig. 27

- Ktheni bulonin në profilin e menteshës në anën tjeter.
- Shtrëngoni bulonin me **momentin e rrotullimit prej 12 Nm**.




Fig. 28

- Vendosni kapakun mbulues.

# Venia në punë

► Sistemi i sipërm i mbylljes konvertohet.

## 4.11.7 Konvertimi i bravës

### 4.11.7 Kthimi i bravës në anën tjetër (bravë elektronike)




Fig. 29

- Hiqni vidat dhe nxirri jashtë bravën.
- Kabloja e lidhur qëndron në bravë. Lironi fiksuesit e mundshëm.




Fig. 30

- Ktheni kapakun mbulues në anën tjetër.




Fig. 31

- Vendosni bravën dhe mbërthejeni.
- Brava elektronike konvertohet në anën tjetër.

### 4.11.8 Kthimi i bazamentit mbështetës në anën tjetër

### 4.11.8 Kthimi i bazamentit mbështetës në anën tjetër (rrota)



#### PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga përbysja e pajisjes! Rrezik për jetën dhe për dëme materiale në pajisje. Kur çmontoni rrotat nga pajisja, ajo mund të përbysjet.

- Përpala se të konvertoni pajisjen: Siguroni pajisjen kundër përbysjes.




Fig. 32

- Lironi rrotat.




Fig. 33

- Lironi rrotat me bazamentin mbështetës.




Fig. 34

- Shkëmbeni kapakët mbulues.




Fig. 35

- Mbërtheni rrotat.




Fig. 36

- Mbërtheni rrotat me bazamentin mbështetës.
- ▷ Bazamenti mbështetës konvertohet në anën tjetër.

## 4.11.9 Konvertimi i derës

### 4.11.9 Konvertimi i derës (derë me shkumë)




Fig. 37

- Nxirri jashtë bokullën e menteshës në anën tjetër.




Fig. 38

- Rrotulloni derën me 180°.




Fig. 39

- Vendosni bokullen e menteshës lart në anën e menteshës (ana e drejtë e drejtuar nga jashtë).
- ▷ Dera me shkumë konvertohet.

## 4.11.10 Montimi i sistemit të poshtëm të mbylljes




Fig. 40

- Shtyni sistemin e mbylljes në derë.




Fig. 41 Dera nga poshtë

- ▷ Drejtimi i sistemit të mbylljes përpëra montimit për hapjen majtas (L) ose hapjen djathtas (R).

## 4.11.11 Montimi i derës

### 4.11.11 Montimi i derës (derë me shkumë)




Fig. 42

- Shtrëngoni lehtë vidën.




Fig. 43

- Futni derën të anuar paksa në pjesën lart Fig. 43 (1), vendosni derën drejt Fig. 43 (2) dhe mbështeteni poshtë mbi vidën e bazamentit mbështetës Fig. 43 (3).




Fig. 44

- Mbërtheni derën.
- Dera me shkumë montohet.

## 4.11.12 Mbyllja e kapakut mbulues të aggregatit




Fig. 45

- Mbyllni kapakun mbulues të aggregatit.

### Shënim

Mos e kapni kabllon.




Fig. 46

- Mbërtheni kapakun mbulues të aggregatit.
- Mbylli derën.
- Krahu i hapjes së derës është ndërruar.

## 4.12 Nivelimi i derës

### 4.12.1 Nivelimi horizontal i derës

Nëse dera nuk është drejt, atëherë mund ta rregulloni derën në profilin e menteshës poshtë.




Fig. 47

- Hiqni vidën e mesit në profilin e menteshës poshtë.




Fig. 48

- Lironi paksa të dyja vidat dhe zhvendoseni derën me profilin e menteshës nga e djathta ose nga e majta.
- Shtrëngoni fort vidat deri në fund (vida e mesit nuk nevojitet më).
- Dera është niveluar drejt.

## 4.13 Lidhja e pajisjes




### PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri nga lidhja e pasaktë!  
Djegie.

Dëmtime në pajisje.

- Mos përdorni kablllo zgjatuese.
- Mos përdorni bashkues me shumë priza.



## KUJDES

Rrezik dëmtimi nga lidhja e pasaktë!

Dëmtime në pajisje.

- Mos e lidhni pajisjen në inverter të pavarur nga rrjeti, si për shembull në impiantet me energji diellore dhe gjeneratorët me benzinë.

## Shënim

Përdorni vetëm kordonin e lidhjes elektrike të ofruar me pajisjen.

Sigurohuni që janë përbushur kushtet e mëposhtme:

- Pajisja punon vetëm me **rrymë alternative**.
- Tensioni dhe frekuencia e lejuar është e stampuar në etiketën e parametrave. Pozicionin e etiketës së parametrave mund të mësoni në kapitullin Pasqyra e pajisjes. (shihni 1.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve)
- Priza elektrike është e tokëzuar dhe e siguruar nga ana elektrike në përputhje me rregullat.
- Rryma e veprimit e siguresës është midis 10 A dhe 16 A.
- Priza elektrike është lehtësisht e arritshme.
- Kontrolloni lidhjen elektrike.
- Futni spinën e pajisjes në pjesën e pasme të pajisjes. Sigurohuni pér futjen në mënyrën e duhur.
- Lidhni spinën elektrike në linjën e furnizimit me energji elektrike.
- Ekrani kalon në simbolin Standby.

## 4.14 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë)

Sigurohuni që janë përbushur kushtet e mëposhtme:

- Pajisja është instaluar dhe është lidhur.
- Të gjithë shiritat ngjitës, fletët ngjitëse dhe mbrojtëse, si dhe sigurueset e transportit brenda dhe jashtë pajisjes janë hequr.




Fig. 49 Shembull ilustrues

- Simboli Standby pulson: Pritni derisa të përfundojë procesi i nisjes.
- Ekrani tregon simbolin Standby.

Nëse pajisja dërgohet me cilësimet nga fabrika, gjatë vëniec në punë duhet që në fillim të vendoset gjuha e ekranit dhe data/ora.




Fig. 50

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Vendoset gjuha.




Fig. 51

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Vendoset temperatura.




Fig. 52

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Vendoset ora.




Fig. 53 Treguesi i statusit

- Pajisja është gati pér punë kur në ekran shfaqet temperatura.
- Treguesi i temperaturës pulson derisa të arrihet temperatura e vendosur.

## 4.15 Vendosja e pjesëve

### 4.15.1 Vendosja e shiritave të kapjes




Fig. 54 Shembull ilustrues

- Futni shiritat e kapjes në vendin e varjes Fig. 54 (1). Shënim Fig. 54 (2) duhet të jetë i drejtuar nga përpara.

### 4.15.2 Vendosja e shinës mbajtëse




Fig. 55 Shembull ilustrues

- Shtyni brenda shinën mbajtëse në shiritin e kapjes prapa dhe vareni përpara.

## 4.16 Rafti i ndërmjetëm me rrjetë

### 4.16.1 Vendosja e raftit të ndërmjetëm me rrjetë




Fig. 56 Shembull ilustrues

- Vendosni raftin e ndërmjetëm me rrjetë mbi shinat mbajtëse.

## 5 Ruajtja

### 5.1 Udhëzime për ruajtjen




Fig. 57 Shembull ilustrues

Gjatë vendosjes në ruajtje mban parasysh:

- Nëse raftet me rrjetë Fig. 57 (1) mund të zhvendosen, atëherë përshtatini sipas lartësisë.
- Mban parasysh ngarkesën maksimale. (shihni 9.1 Të dhënat teknike)
- Mbusheni pajisjen pasi të jetë arritur temperatura e ruajtjes (respektimi i zinxhirit të ftohjes).
- Produktet për ftohje nuk duhet të prekin faqen e pasme.
- Mos ruani produkte për ftohje mbi ndaluesin e pasmë të rafteve me rrjetë.
- Ruani lëngjet në enë të myllura.
- Vendosni ushqimet për ftohje me distancë nga njëratjetra, me qëllim që ajri të mund të qarkullojë mirë.
- Produkti në ftohje nuk duhet të kalojë shenjat e raftit.



Kjo është e rëndësishme për një qarkullim pa probleme të ajrit dhe për shpërndarjen e njëtrajtshme të temperaturës në të gjithë hapësirën e brendshme.

## 6 Përdorimi

### 6.1 Elementët e komandimit dhe tregues

Ekrani mundëson një shikim të shpejtë të gjendjes aktuale të pajisjes, të temperaturës së vendosur, të gjendjes së funksioneve dhe të cilësimeve, si dhe të mesazheve të alarmit dhe të gabimeve.

Përdorimi bëhet direkt nëpërmjet ekranit Touch & Swipe me rrëshqitje dhe prekje.

Është e mundur që të aktivizohen ose të çaktivizohen funksione dhe të ndryshohen vlerat e cilësimeve.




Fig. 58 Ekrani Touch & Swipe  
(1) Treguesi i statusit

### 6.1.1 Treguesi i statusit




Fig. 59 Treguesi i statusit  
(1) Temperatura aktuale  
(2) Statusi i alarmit  
(3) Statusi i procesit të shkrirjes  
(4) Statusi i bllokimit të derës

Treguesi i statusit është treguesi i daljes.

Ai tregon në mes temperaturën dhe tre simbole në pjesën e poshtme. Treguesi i statusit mund të paraqesë simbole të tjera të ndryshme treguese.

Nga treguesi i statusit vijohet me navigimin në funksionet dhe cilësimet e tjera.

### 6.1.2 Simbolet treguese

Simbolet treguese janë informacion rrith gjendjes aktuale të pajisjes.

Simboli	Gjendja e pajisjes
	<b>Simboli Standby</b> Pajisja është fikur.
	<b>Simboli Standby (pulson)</b> Pajisja është duke punuar.
	<b>Temperatura (pulson)</b> Temperatura e synuar nuk është arritur akoma. Pajisja ftoh në temperaturën e vendosur.
	<b>Treguesi i statusit (rrethuar me kornizë të bardhë)</b> Pajisja është kyçur.

Simboli	Gjendja e pajisjes
	<b>D në ekran</b> Pajisja është në modalitetin e demonstrimit.
	<b>Treguesi i mirëmbajtjes (i verdhë)</b> Intervali kohor i përcaktuar është kapercyer.
	<b>Memoria e të dhënave plot (e verdhë)</b> Memoria e të dhënave (999 orë) është plot. Nga ky moment, të dhënat më të vjetra zëvendësohen nga më të rejtat.
	<b>Memoria e alarmeve plot (e verdhë)</b> Memoria e alarmeve është plot. Fshini alarme të veçanta ose të gjithë memorien.
	<b>Hapja manuale e derës (e verdhë)</b> Dera e mbyllur është hapur manualisht.
	<b>Simboli i gabimit (i kuq)</b> Pajisja është në gjendje defekti.
	<b>Sfondi (blu)</b> Cilësim aktiv ose funksion aktiv
	<b>Vija (që zgjatet)</b> Mbani shtypur për 3 sekonda, për ta aktivizuar cilësimin.
	<b>Vija (që shkurtohet)</b> Mbani shtypur për 3 sekonda, për ta çaktivizuar cilësimin.

#### Simboli i treguesit të statusit

Simbolet shtesë në anën e poshtme të ekranit të statusit mundësojnë një qasje të shpejtë në informacionet e alarmeve dhe në detajet e gjendjes së pajisjes.

Simboli	Gjendja e pajisjes
	<b>Simboli i alarmit (gri)</b> Arkivi i alarmeve është bosh. Prekja e shkurtër hap arkivin e alarmeve.
	<b>Simboli i alarmit (i bardhë)</b> Në arkivin e alarmeve ka alarme të konfirmuara. Prekja e shkurtër hap arkivin e alarmeve.
	<b>Simboli i alarmit (i kuq)</b> Në arkivin e alarmeve ka alarme që nuk janë konfirmuar akoma. Prekja e shkurtër hap arkivin e alarmeve.

Simboli	Gjendja e pajisjes
	<b>Simboli i alarmit (i kuq, që pulson)</b> Në arkiv ka një alarm aktiv. Prekja e shkurtër hap arkivin e alarmeve.
	<b>Simboli i shkrirjes (gri)</b> Nuk ka proces shkrirjeje aktiv.
	<b>Simboli i shkrirjes (i bardhë, që pulson)</b> Procesi i shkrirjes manuale aktiv. Prekja e shkurtër hap shkrirjen manuale. (shihni 6.2.23 Shkrirja )
	<b>Simboli i shkrirjes (i bardhë)</b> Procesi i shkrirjes automatiqe i aktivizuar. Funksioni nuk mund të ndërpritet.
	<b>Simboli i bravës së derës (i bardhë, i mbyllur)</b> Kyçja e derës është aktive. Prekja e shkurtër hap futjen e kodit për hapjen e derës. (shihni 6.2.6 Bllokimi i derës )
	<b>Simboli i bravës së derës (i bardhë, i hapur)</b> Kyçja e derës është joaktive. Prekja e shkurtër hap futjen e kodit për bllokimin e derës. (shihni 6.2.6 Bllokimi i derës )

Simbolet shtesë të treguesit të statusit

## 6.1.3 Sinjalet akustike

Një sinjal akustik tingëllon në rastet e mëposhtme:

- Kur konfirmohet një funksion ose një vlerë.
- Kur një funksion ose një vlerë nuk mund të aktivizohet ose të çaktivizohet.
- Sapo shfaqet një gabim.
- Në rastin e një mesazhi alarmi.

Tingujt e alarmeve mund të aktivizohen dhe të çaktivizohen në menynë Klienti.

## 6.2 Funksionet e pajisjes

### 6.2.1 Udhëzime për funksionet e pajisjes

Funksionet e pajisjes janë konfiguruar në mënyrë të tillë nga fabrika që pajisja juaj të jetë plotësisht funksionale.

Përpara se të ndryshoni, të aktivizoni ose të çaktivizoni funksionet e pajisjes, sigurohuni që janë përbushur kushtet e mëposhtme:

- Ju keni lexuar dhe keni kuptuar pëershkrimet për mënyrën e funksionimit të ekranit. (shihni 3 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)
- Ju jeni familjarizuar me elementët e komandimit dhe elementët tregues të pajisjes suaj. (shihni 6.1 Elementët e komandimit dhe tregues)



### 6.2.2 Ndezja dhe fikja e pajisjes

Ky funksion mundëson ndezjen dhe fikjen e të gjithë pajisjes.

### Ndezja e pajisjes

Pa modalitetin e demonstrimit të aktivizuar:




Fig. 60

► Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

Me modalitetin e demonstrimit të aktivizuar:




Fig. 61

► Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

### Shënim

Çaktivizoni modalitetin e demonstrimit përparrë përfundimit të numërimit zbritës.




Fig. 62 Treguesi i statusit

► Treguesi i temperaturës shfaqet në ekran.

### Fikja e pajisjes



Fig. 63




Fig. 64

► Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

► Ekrani tregon simbolin Standby.

► Ekrani fiket pas rreth 10 minutave.



### 6.2.3 Temperatura

Temperatura varet nga faktorët e mëposhtëm:

- shpeshtësia e hapjes së derës
- kohëzgjatja e hapjes së derës
- temperatura e dhomës në vendin e instalimit
- lloji, temperatura dhe sasia e ushqimit përmirësuar

## Shënim

Në disa vende të hapësirës së brendshme, temperatura e ajrit mund të jetë e ndryshme nga treguesi i temperaturës.

Me temperaturën e duhur, ushqimi për ngirje rron më gjatë. Në këtë mënyrë mund të shmanget hedha e tepruar e ushqimeve.

## Vendosja e temperaturës

Hapat e veprimit në vijim përkruajnë sesi të rritni temperaturën, për shembull nga -33,3 °C në -31,8 °C.




Fig. 65




Fig. 66

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Temperatura vendoset.

## 6.2.4 Regjistrimi i temperaturave



Me këtë funksion pajisja tregon temperaturën minimale dhe maksimale të hapësirës së brendshme. Regjistrimi i tyre fillojn automaticisht pas ndezjes së pajisjes, me një interval prej një minute. Pasi të kenë kaluar 999 orë (rreth 40 ditë) shfaqet një udhëzim që tregon se memoria e të dhënavës është plot. Pas kësaj, regjistrimi i temperaturave duhet rivendosur nga fillimi.

## Shënim

Në mënyrë të pavarur nga ky funksion, regjistrohet gjithashtu edhe seuria e temperaturave dhe mesazhet e alarmit dhe të shërbimit. Këto të dhëna mund të eksportohen dhe të ruhen në një memorie USB. (shihni 6.2.24 Shkarkimi i të dhënavë / Datalogging )

Nëse në pajisje do të kishte një sensor shtesë për produktet, ekziston mundësia që ky të zgjidhet për të shfaqur temperaturën minimale dhe maksimale. (shihni 6.2.25 Kalibrimi i sensorit )

## Shënim

Regjistrimi i temperaturave gjatë vënies në punë të pajisjes duhet të rivendoset një herë nga fillimi **pas arritjes së temperaturës së vendosur**. (shihni Rivendosja e regjistrimit të temperaturave) Në këtë mënyrë vlera e temperaturës maksimale bëhet e rëndësishme.

## Shikimi i regjistrimit të temperaturave

Regjistrimi i temperaturave tregon kohëzgjatjen e regjistrimit dhe temperaturën minimale dhe maksimale të matur gjatë kësaj kohe.




Fig. 67



Fig. 68

- Shfaqet ekran i statusit me regjistrimet e temperaturave.

## Rivendosja e regjistrimit të temperaturave

Temperaturat minimale dhe maksimale të treguara mund të rivendosen në çdo kohë. Për këtë, vlerat e treguara fshihen dhe intervali i regjistrimit fillohet nga e para.




Fig. 69




Fig. 70

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Regjistrimi i temperaturave rivendoset nga fillimi.




## 6.2.5 Ndriçimi

Light

Pajisja është e pajisur me ndriçim të brendshëm.

Kur hapni derën e pajisjes, ndriçimi i brendshëm do të ndizet. Gjithashtu, ju mund ta çaktivizoni këtë funksion.



## 6.2.6 Bllokimi i derës

Door lock

Pajisja është e pajisur me një bllokim dere elektronik. **Në vënien në punë herën e parë dera është e shkyçur** dhe ju mund ta hapni atë.

Ky funksion bën të mundur që ta siguron pajisjen kundër tërheqjes së paqëllimshme.

# Përdorimi

Për këtë ju keni mundësitet e mëposhtme të konfigurimit:

- Të kyçni derën me kodin e derës.
- Të shkyçni derën me kodin e derës.
- Të aktivizoni funksionin e bllokimit automatik.
- Të çaktivizoni funksionin e bllokimit automatik.
- Të konfiguroni vonesën kohore të bllokimit automatik.
- Të ndryshoni kodin e derës. (shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)
- Të rivendosni kodin e derës. (shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)
- Të çiftoni telekomandën. (shihni 6.2.10 Telekomanda )

## Kyçja e derës me kodin e derës

### Shënim

- Në shembullin në vijim përdoret kodi PIN: **1 1 1 1** i caktuar nga fabrika.




Fig. 71 Treguesi i statusit

Futja e kodit të derës fillon duke u nisur nga treguesi i statusit, duke prekur mbi simbolin e drynit të hapur.




Fig. 72 Kyçni derën me kodin e derës 1 1 1 1.

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 73 Treguesi i statusit me kornizën rrethuese të bardhë

- Dera është e kryçur.

## Shkyçja e derës me kodin e derës

### Shënim

- Në shembullin në vijim përdoret kodi PIN: **1 1 1 1** i caktuar nga fabrika.




Fig. 74 Treguesi i statusit me kornizën rrethuese të bardhë




Fig. 75 Shkyçni derën me kodin e derës 1 1 1 1.

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.



Fig. 76 Treguesi i statusit

- Treguesi i statusit shfaqet me simbolin e drynit të hapur.  
► Dera është e shkyçur.

## Aktivizimi i funksionit të bllokimit automatik




Fig. 77




Fig. 78

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.  
► Funksioni i bllokimit automatik aktivizohet.  
► Tani mund të vendoset edhe vonesa kohore (shihni Konfigurimi i vonesës kohore të bllokimit automatik).

## Shënim

Gjithashtu, ju mund ta kyçni dhe ta shkyçni derën me telekomandë (shihni 6.2.10 Telekomanda ) ose duke futur kodin e derës.

## Çaktivizimi i funksionit të bllokimit automatik




Fig. 79




Fig. 80

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Funkzioni i bllokimit automatik çaktivizohet.

### Konfigurimi i vonesës kohore të bllokimit automatik

Ky funksion përcakton vonesën kohore të bllokimit automatik të derës, pas hapjes së derës.

Sigurohuni që janë përbushur kushtet e mëposhtme:

- Bllokuesi automatik i derës (shihni Aktivizimi i funksionit të bllokimit automatik) është i aktivizuar.



Fig. 81




Fig. 82 Këtu mund të vendosen vlerat e mëposhtme: 5, 15, 60, 90, 120, 180 dhe 240 sekonda

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Vonesa kohore është vendosur.

### Ndryshimi i kodit të derës

(shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)

### Rivendosja e kodit të derës

(shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)

### Çiftimi i telekomandës

(shihni 6.2.10 Telekomanda )



## 6.2.7 SmartLock

Për të penguar marrjen e produkteve në ftohje, ky funksion mundëson një bllokim automatik të derës pas aktivizimit të alarmit të temperaturës. (shihni 6.2.26 Alarmi i temperaturës ) Koha e vonesës së bllokimit mund të përshtatet. Pas kësaj, hapja e derës është e mundur vetëm duke futur kodin PIN të SmartLock.

### Përdorimi:

- Aktivizoni SmartLock.
- Çaktivizoni SmartLock.
- Vendosja e vonesës së bllokimit.
- Zhbllokoni bravën e derës me kodin PIN të SmartLock.
- Ndryshoni kodin PIN të SmartLock. (shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)
- Rivendosni kodin PIN të SmartLock. (shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)

### Aktivizimi i SmartLock

#### Shënim

- Në shembullin në vijim përdoret kodi PIN: **1 1 1 1** i caktuar nga fabrika.



Fig. 83




Fig. 84

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ SmartLock është aktivizuar.
- ▷ Tani mund të zgjidhet intervali i vonesës së bllokimit. (shihni Vendosja e vonesës së bllokimit)

### Çaktivizimi i SmartLock

#### Shënim

- Në shembullin në vijim përdoret kodi PIN: **1 1 1 1** i caktuar nga fabrika.



Fig. 85




Fig. 86

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ SmartLock çaktivizohet.

## Vendosja e vonesës së bllokimit

Sigurohuni që janë përbushur kushtet e mëposhtme:

- SmartLock duhet të jetë aktive. (shihni Aktivizimi i SmartLock)



Fig. 87




Fig. 88 Këtu mund të vendosen vlerat e mëposhtme: Off (asnje kohë pritjeje) deri në 60 minuta; në hapa me nga 1 minutë

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Koha e vonesës së bllokimit vendoset.

## Zhbllokimi i bravës së derës me kodin PIN të SmartLock

Pas aktivizimit të alarmit të temperaturës (shihni 6.2.26 Alarmi i temperaturës) dera bllokohet automatikisht nëpërmjet funksionit SmartLock.

Tani hapja e derës është e mundur vetëm me kodin PIN të SmartLock.

### Shënim

- ▶ Në shembullin në vijim, kodi PIN i SmartLock që përdoret është: **2 3 4 5**

Futja e kodit PIN të SmartLock fillon duke u nisur nga treguesi i statusit. Do të shfaqen informacionet përfunksionin SmartLock dhe regjistrimin e temperaturës së alarmit të temperaturës.




Fig. 89

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Dera është e shkyçur.




Fig. 90 Treguesi i statusit

- ▷ Treguesi i temperaturës shfaqet në ekran.

## Ndryshimi i kodit PIN të SmartLock

(shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)

## Rivendosja e kodit PIN të SmartLock

(shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)

## 6.2.8 Siguria e aksesit në menynë Cilësimet



Ky funksion mundëson sigurinë e aksesit në menynë Cilësimet nëpërmjet një kodit PIN me katër numra.

Përdorimi:

- Shmangni ndryshimin pa qëllim të cilësimeve dhe të funksioneve.
- Shmangni fikjen pa qëllim të pajisjes.
- Shmangni rregullimin pa qëllim të temperaturës.

## Aktivizimi i sigurisë së aksesit në menynë Cilësimet

### Shënim

- ▶ Në shembullin në vijim përdoret kodi PIN: **1 1 1 1** i caktuar nga fabrika.




Fig. 91




Fig. 92

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Siguria e aksesit në menynë Cilësimet aktivizohet.

#### Ndryshimi i kodit PIN të sigurisë së aksesit në menynë Cilësimet

(shihni 6.2.9 Kodet e aksesit)

#### Çaktivizimi i sigurisë së aksesit në menynë Cilësimet

##### Shënim

- ▶ Në shembullin në vijim përdoret kodi PIN: **1 1 1 1** i caktuar nga fabrika.



Fig. 93




Fig. 94

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Siguria e aksesit në menynë Cilësimet çaktivizohet.

#### Hapja e menysë së siguruar Cilësimet

Kur siguria e aksesit në menynë Cilësimet është aktive, nevojitet futja e kodit PIN për të hapur menynë Cilësimet.

Pas futjes së kodit të saktë PIN, menya Cilësimet qëndron e zhbllokuar për 20 minuta.

##### Shënim

- ▶ Në shembullin në vijim përdoret kodi PIN: **1 1 1 1** i caktuar nga fabrika.

#### Siguria e aksesit në menynë Cilësimet duhet të jetë aktive.

- ▶ Rrëshqitni me gisht majtas ose djathtas derisa të shfaqet funksioni përkatës.




Fig. 95

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Kodi PIN i saktë: Hapet menya Cilësimet.

#### 6.2.9 Kodet e aksesit

Janë të mundura konfigurime të ndryshme.

Përdorimi:

- Ndryshimi i kodit të derës.
- Rivendosja e kodit të derës.
- Ndryshimi i kodit të cilësimeve.
- Rivendosja e kodit të cilësimeve.
- Ndryshimi i kodit të SmartLock.
- Rivendosja e kodit të SmartLock.



Kodi i derës

#### Ndryshimi i kodit të derës

Ky cilësim mundeson ndryshimin e kodit të derës, të bllokimit të derës.

Rregullimi bëhet në 3 hapa:

- Futja e kodit të vjetër të derës
- Futja e kodit të ri të derës
- Konfirmimi i kodit të ri të derës

##### Shënim

- ▶ Në shembullin në vijim tregohet ndryshimi i kodit të derës të paracaktuar nga fabrika **1 1 1 1**.
- ▶ Kodi i ri i derës është: **2 3 4 5**



Fig. 96

# Përdorimi




Fig. 97

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Futja e kodit të vjetër të derës me sukses.




Fig. 98

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Futja e kodit të ri të derës me sukses.




Fig. 99

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Konfirmimi i kodit të ri të derës me sukses.
- ▷ Kodi i derës ndryshohet.
- Çifttoni përsëri telekomandën. (shihni 6.2.10 Telekomanda )

## Rivendosja e kodit të derës

Kodi i derës është harruar ose nuk dihet.

- Riktheni pajisjen në cilësimet nga fabrika. (shihni 6.2.33 Rikthimi në cilësimet nga fabrika )
- Pajisja rikthehet në cilësimet fillestare të saj.
- ▷ Kodi i derës i caktuar nga fabrika është: **1 1 1 1**



## Siguria e aksesit në menynë Cilësimet

### Ndryshimi i kodit të cilësimeve

Ky cilësim mundëson ndryshimin e kodit të cilësimeve, për sigurinë e aksesit në menynë Cilësimet.

Rregullimi bëhet në 3 hapa:

- Futja e kodit të vjetër të cilësimeve
- Futja e kodit të ri të cilësimeve
- Konfirmimi i kodit të ri të cilësimeve

### Shënim

- Në shembullin në vijim tregohet ndryshimi i kodit të cilësimeve të paracaktuar nga fabrika **1 1 1 1**.
- Kodi i ri i cilësimeve është: **2 3 4 5**




Fig. 100

## Siguria e aksesit në menynë Cilësimet duhet të jetë aktive.

(shihni 6.2.8 Siguria e aksesit në menynë Cilësimet )

- Rrëshqitni me gisht majtas ose djathtas derisa të shfaqet funksioni përkatës.




Fig. 101

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Futja e kodit të vjetër të cilësimeve me sukses.




Fig. 102

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Futja e kodit të ri të cilësimeve me sukses.




Fig. 103

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Konfirmimi i kodit të ri të cilësimeve me sukses.
- ▷ Kodi i cilësimeve ndryshohet.

### Rivendosja e kodit të cilësimeve

Kodi i cilësimeve për sigurinë e aksesit në menynë Cilësimet është harruar ose nuk dihet.

- Riktheni pajisjen në cilësimet nga fabrika (shihni 6.2.33 Rikthimi në cilësimet nga fabrika).
- ▷ Pajisja rikthehet në cilësimet fillestare të saj.
- ▷ Kodi i derës i cilësimeve nga fabrika është: **1 1 1 1**



**SmartLock**

### Ndryshimi i kodit të SmartLock

Ky cilësim mundëson ndryshimin e kodit të SmartLock.

Rregullimi bëhet në 3 hapa:

- Futja e kodit të vjetër të SmartLock
- Futja e kodit të ri të SmartLock
- Konfirmimi i kodit të ri të SmartLock

### Shënim

- Në shembullin në vijim tregohet ndryshimi i kodit të SmartLock të paracaktuar nga fabrika **1 1 1 1**.
- Kodi i ri i SmartLock është: **2 3 4 5**



Fig. 104

- **SmartLock duhet të jetë aktive.** (shihni 6.2.7 SmartLock)
- ▷ Rrëshqitni me gisht majtas ose djetas derisa të shfaqet funksioni përkatës.




Fig. 105

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Futja e kodit të vjetër të SmartLock me sukses.




Fig. 106

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Futja e kodit të ri të SmartLock me sukses.




Fig. 107

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Konfirmimi i kodit të ri të SmartLock me sukses.

# Përdorimi

▷ Kodi i SmartLock ndryshohet.

## Rivendosja e kodit të SmartLock

Kodi i SmartLock është harruar ose nuk dihet.

- Riktheni pajisjen në cilësimet nga fabrika. (shihni 6.2.33 Rikthimi në cilësimet nga fabrika )
- ▷ Pajisja rikthehet në cilësimet fillestare të saj.
- ▷ Kodi i derës i SmartLock i paracaktuar nga fabrika është: **1 1 1 1**



## 6.2.10 Telekomanda

Në gjendjen e dërgimit, në telekomandë është ruajtur një kod PIN nga fabrika që hap çdo pajisje me cilësimet nga fabrika të pandryshuara (shihni 6.2.33 Rikthimi në cilësimet nga fabrika ). Në këtë mënyrë, shumë pajisje mund të hapen dhe të mbyllen me një telekomandë të vetme. Nëpërmjet çiftimit krijohet një kod PIN specifik për pajisjen, i cili nga ky moment mund të hapë ose të mbyllë vetëm pajisjen e regjistruar. Rikthimi në gjendjen e fabrikës rikthen përsëri funksionalitetin fillesttar.

### Shënim

Rezja e telekomandës është rreth 15 m.

Përdorimi:

- Çiftoni telekomandën.
- Shkëputni telekomandën.

## Çiftimi i telekomandës



Fig. 108




Fig. 109

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Shtypni dy herë një buton në telekomandë.
- ▷ Treguesi LED i statusit në telekomandë pulson tre herë.
- ▷ Telekomanda është lidhur me pajisjen.

## Shkëputja e telekomandës



Fig. 110




Fig. 111

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Pulti i komandimit me valë shkëputet nga pajisja.

## 6.2.11 Kujtesa e intervalit të mirëmbajtjes



Vendosja e intervalit kohor, deri në të cilin do të rikujtohet mirëmbajtja.

Mund të vendosen vlerat e mëposhtme:

- 7 ditë
- 14 ditë
- 30 ditë
- 60 ditë
- 90 ditë
- 180 ditë
- 360 ditë
- 720 ditë
- 1080 ditë
- Fikur

## Vendosja e kujtesës së intervalit të mirëmbajtjes

Hapat e veprimit në vijim përshkruajnë sesi të vendosni periudhën kohore deri në mirëmbajtje.




Fig. 112




Fig. 113

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Vendosja e intervalit kohor, deri në të cilin do të rikujtohet mirëmbajtja, do të vendoset.
- ▷ Do të shfaqet koha e mbetur.



## 6.2.12 Gjuha

Me këtë cilësim vodoset gjuha e afishimit në ekran.

### Vendosja e gjuhës



Fig. 114




Fig. 115

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Gjuha e zgjedhur do të vodoset.

## 6.2.13 Data dhe ora

Ky cilësim mundëson vodosjen e datës dhe të orës.

### Vendosja e datës dhe orës



Fig. 116



Fig. 117

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 118

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Data do të vodoset.




Fig. 119

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Ora do të vodoset.



## 6.2.14 Njësia e temperaturës

Me këtë funksion ju vodosni njësinë e temperaturës. Ju mund të vodosni gradë Celsius ose gradë Fahrenheit si njësi të temperaturës.

### Vendosja e njësës së temperaturës



Fig. 120




Fig. 121 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga gradë Celsius në gradë Fahrenheit.

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Njësia e temperaturës do të vodoset.



## 6.2.15 Niveli i dritës së ekranit

Me këtë funksion ju rregulloni në mënyrë graduale nivelin e dritës së ekranit.

Ju mund të vodosni nivelet e mëposhtme të dritës:

- 40 %
- 60 %
- 80 %
- 100% (Cilësimi i paracaktuar)

# Përdorimi

## Vendosja e nivelit të dritës




Fig. 122




Fig. 123 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga 80% në 60%.

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Niveli i dritës do të vendoset.

## 6.2.16 Alarm Sound



## Aktivizimi i Alarm Sound



Fig. 124




Fig. 125

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Alarm Sound është aktivizuar.

## Çaktivizimi i Alarm Sound




Fig. 126



Fig. 127

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Alarm Sound çaktivizohet.

## 6.2.17 Key Sound



Ky funksion mundëson aktivizimin dhe çaktivizimin e të gjithë tingujve të butonave, të tingujve të konfirmimit dhe të tingullit të ndezjes.

## Aktivizimi i Key Sound




Fig. 128



Fig. 129

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Key Sound është aktivizuar.

## Çaktivizimi i Key Sound




Fig. 130



Fig. 131

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Key Sound çaktivizohet.



## 6.2.18 Lidhja e WLAN



### Shënim

Liebherr SmartMonitoring Dashboard nuk ofrohet në të gjitha shtetet. Kontrolloni disponueshmërinë e tij përmes kodit QR, duke futur modelin tuaj.

### Shënim

Përdorimi i Liebherr SmartMonitoring Dashboard te <https://smartmonitoring.liebherr.com> kërkon si parakusht instalimin e një moduli SmartModule dhe një llogari tregtare te MyLiebherr. Gjatë vënieve në punë online, ju mund të identifikoheni direkt me të dhënat tuaja ekzistuese të regjistrimit ose të regjistroheni nga e para dhe të krijoni një llogari të firmës.

Ky cilësim vendos një lidhje pa kabllo/me valë midis pajisjes dhe internetit. Lidhja komandohet nëpërmjet modulit SmartModule. Pajisja mund të lidhet nëpërmjet **Liebherr SmartMonitoring Dashboard** që bazohet te shfletuesit, dhe përmes kësaj të përdoren opsione të zgjeruara dhe mundësi individuale për komandimin, administrimin dhe monitorimin.




Fig. 132

Sigurohuni që janë përbushur kushtet e mëposhtme:

- Moduli SmartModule Fig. 132 (1) është vendosur.

## Realizimi i lidhjes

Vëni në punë dhe konfigurimin e SmartModule mund ta bëni online nëpërmjet [Liebherr SmartMonitoring Dashboard](#) në pajisjen tuaj celulare të pajisur me internet.




Fig. 133

- Hapni [Liebherr SmartMonitoring Dashboard](#). (shihni Fig. 133)

Në frigoriferin ftohës ose ngrirës:



Fig. 134

## Shënim

Siguria e aksesit në menynë Cilësimet aktivizohet. (shihni 6.2.8 Siguria e aksesit në menynë Cilësimet )

- Futni kodin PIN të zgjedhur. Menja Cilësimet hapet.



Fig. 135




Fig. 136

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Vazhdoni procesin e konfigurimit në pajisjen celulare me internet: [Liebherr SmartMonitoring Dashboard](#)




Fig. 137

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Lidhja po vendoset: Shfaqet WiFi connecting. Simboli pulson.
- Ndzini udhëzimet te [Liebherr SmartMonitoring Dashboard](#).
- Lidhja është vendosur.

## Shkëputja e lidhjes




Fig. 138

## Shënim

Siguria e aksesit në menynë Cilësimet aktivizohet. (shihni 6.2.8 Siguria e aksesit në menynë Cilësimet )

- Futni kodin PIN të zgjedhur. Menja Cilësimet hapet.



Fig. 139




Fig. 140

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Lidhja është shkëputur.

## Rivendosja e lidhjes



Fig. 141

## Shënim

Siguria e aksesit në menynë Cilësimet aktivizohet. (shihni 6.2.8 Siguria e aksesit në menynë Cilësimet )

- Futni kodin PIN të zgjedhur. Menja Cilësimet hapet.



Fig. 142




Fig. 143

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Cilësimet e WiFi rikthehen në gjendjen e dërgimit të pajisjes.

## 6.2.19 Lidhja e LAN



### Shënim

Liebherr SmartMonitoring Dashboard nuk ofrohet në të gjitha shtetet. Kontrolloni disponueshmërinë e tij përmes kodit QR, duke futur modelin tuaj.

### Shënim

Përdorimi i Liebherr SmartMonitoring Dashboard te <https://smartmonitoring.liebherr.com> kërkon si parakusht instalimin e një moduli SmartModule dhe një llogari tregtare te MyLiebherr. Gjatë vënies në punë online, ju mund të identifikoheni direkt me të dhënat tuaja ekzistuese të regjistrimit ose të regjistroheni nga e para dhe të krijoni një llogari të firmës.

Ky cilësim vendos një lidhje me kabllo midis pajisjes dhe internetit. Lidhja komandohet nëpërmjet modulit SmartModule. Pajisja mund të lidhet nëpërmjet **Liebherr SmartMonitoring Dashboard** që bazohet te shfletuesit, dhe përmes kësaj të përdoren opsione të zgjeruara dhe mundësi individuale për komandimin, administrimin dhe monitorimin.




Fig. 144

Sigurohuni që janë përbushur kushtet e mëposhtme:

- Moduli SmartModule Fig. 144 (1) është vendosur.
- Kablloja e rrjetit lokal është lidhur.

### Realizimi i lidhjes

Vënien në punë dhe konfigurimin e SmartModule mund ta bëni online nëpërmjet **Liebherr SmartMonitoring Dashboard** në pajisjen tuaj celulare të pajisur me internet.




Fig. 145

- ▶ Hapni **Liebherr SmartMonitoring Dashboard**. (shihni Fig. 145)

Në frigoriferin ftohës ose ngrirës:



Fig. 146

### Shënim

Siguria e aksesit në menynë Cilësimet aktivizohet. (shihni 6.2.8 Siguria e aksesit në menynë Cilësimet )

- ▶ Futni kodin PIN të zgjedhur. Menja Cilësimet hapet.




Fig. 147

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Lidhja po vendoset: Shfaqet LAN connecting. Simboli pulson.
- ▶ Ndizni udhëzimet te **Liebherr SmartMonitoring Dashboard**.
- ▷ Lidhja është vendosur.

### Shkëputja e lidhjes



Fig. 148

### Shënim

Siguria e aksesit në menynë Cilësimet aktivizohet. (shihni 6.2.8 Siguria e aksesit në menynë Cilësimet )

- ▶ Futni kodin PIN të zgjedhur. Menja Cilësimet hapet.




Fig. 149

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Lidhja është shkëputur.

## 6.2.20 Informacioni i pajisjes

Me këtë funksion ju shikoni emrin e modelit, indeksin, numrin e serisë dhe numrin e shërbimit të pajisjes suaj. Informacionet e pajisjes ju nevojiten kur kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 9.3 Shërbimi për klientin)

Me këtë funksion hapni gjithashtu menynë e zgjeruar. (shihni 3 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)

### Shikimi i informacioneve të pajisjes



Fig. 150



Fig. 151

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Ekrani tregon informacionet e pajisjes.

## 6.2.21 Orët e punës

Kjo pamje e ekranit tregon orët e punës së pajisjes.

### Shikimi i orëve të punës



Fig. 152



Fig. 153

- Shfaqen orët e punës.

## 6.2.22 Software

Me këtë funksion ju shikoni versionin e softuerit të pajisjes suaj.

### Shikimi i versionit të softuerit



Fig. 154




Fig. 155

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

► Ekrani tregon versionin e softuerit.



## 6.2.23 Shkrirja

Manual defrost

Në funksionim normal pajisja shkrin automatikisht.

Përdorimi:

- Kur në hapësirën e brendshme ndodh një formim më i madh i akullit, funksioni i shkrirjes automatike mund të niset manualisht.

### Nisja manuale e shkrirjes automatike



Fig. 156




Fig. 157

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Shkrirja automatike është nisur. Pas përfundimit të shkrirjes, pajisja kalon sërisht automatikisht në funksionim normal.

### Shënim

Nëse pas disa nisjeve të shkrirjes automatike ka gjithmonë ende akull në brendësi të pajisjes, shkrijeni pajisjen në mënyrë manuale. (shihni 8.2 Shkrirja e pajisjes)

### Anulimi i shkrirjes së nisur manualisht



Fig. 158




Fig. 159

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Shkrirja e nisur manualisht ndërpritet. Pajisja kalon sërisht automatikisht në funksionim normal.



## Informacioni i shkrirjes

Me këtë cilësim përshtatet shfaqja gjatë një shkrirjeje automatike.

Në dispozicion janë variantet e shfaqjes më poshtë:

- **Def 1:** Treguesi i temperaturës nuk freskohet dhe tregon temperaturën e fundit që nga nisja e shkrirjes automatike.
- **Def 2:** Simboli „Shkrirje automatike“ do të shfaqet në ekranin e statusit. Treguesi i temperaturës freskohet vazhdimisht dhe tregon temperaturën aktuale.
- **Def 3:** Treguesi i temperaturës freskohet vazhdimisht dhe tregon temperaturën aktuale.
- **Def 4:** Simboli „Shkrirje automatike“ do të shfaqet në ekranin e statusit. Treguesi i temperaturës nuk freskohet dhe tregon temperaturën e fundit që nga nisja e shkrirjes automatike.



Fig. 160 Simboli „Shkrirje automatike“



Fig. 161




Fig. 162

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Do të zgjidhet varianti i shfaqjes që dëshironi.

## 6.2.24 Shkarkimi i të dhënavë / Datalogging



Pajisja regjistron automatikisht të gjithë ecurinë e temperaturës së sensorëve të ndryshëm, si dhe mesazhet e alarmeve dhe të shërbimit. Regjistrimi fillon automatikisht pas ndezjes së pajisjes dhe ai kryhet me një interval prej një minute. Të dhënat e 5 viteve të fundit ruhen dhe mund të shkarkohen në çdo kohë në një njësi USB.

Për shkarkim mund të zgjidhen grupet e mëposhtme të të dhënavë:

- Temperaturat
- Alarmet
- Mesazhet e shërbimit
- Të gjitha

Grupet e përzgjedhura të të dhënavë ruhen për të gjithë kohën e regjistrimit si skedarë teksti të pakoduar me mbaresën e skedarit „.log“.

## Shkarkimi i të dhënavë në njësinë USB

### Shënim

Në ndërfaqen USB mund të lidhen vetëm njësi memorie USB. Disqet e jashtme me USB nuk njihen.

### Shënim

Mos e hiqni njësinë e memories USB gjatë shkarkimit të të dhënavë.

Sigurohuni që janë përmbrushur kushtet e mëposhtme:

- Njësi memorie USB 2.0, me formatim FAT32.
- Njësia USB është e lidhur.



Fig. 163




Fig. 164

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Shkarkimi i të dhënavë në njësinë USB me sukses.
- ▷ Grupet e tjera të të dhënavë mund të përzgjidhen dhe të shkarkohen.



## 6.2.25 Kalibrimi i sensorit

Kalibrimi i sensorit shërben për të krahasuar diferençat midis temperaturës që tregohet dhe temperaturës reale ekzistuese në pajisje.

Diapazoni i vendosjes i sensorit C (sensori i kontrollit): +/- 3 Kelvin në hapa 0,1 Kelvin.

Diapazoni i vendosjes i sensorit P (sensori i produkteve): +/- 9,9 Kelvin në hapa 0,1 Kelvin

### Kalibrimi i sensorit




Fig. 165




Fig. 166

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Sensori C kalibrohet.




Fig. 167

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Sensori P kalibrohet.
- ▷ Kalibrimi i sensorit ka përfunduar.

## Shënim

Temperatura e kalibruar tregohet në ekran brenda dy orëve.



### 6.2.26 Alarmi i temperaturës

Alarmi i temperaturës aktivizohet menjëherë sa po temperatura e hapësirës së brendshme devijon nga diapazoni i caktuar i temperaturave dhe koha e mundshme e vendosur për vonesën ka kaluar.

Mund të vendosen vlerat e mëposhtme:

- Kufiri i poshtëm i temperaturës në hapa  $0,1^{\circ}\text{C}$
- Kufiri i sipërm i temperaturës në hapa  $0,1^{\circ}\text{C}$
- Koha e vonesës së alarmit nga 0 deri në 60 minuta (regullimi „0“ nënkupton që nuk ka përsëritje të alarmit në relenë e alarmit.)
- Frekuencia e përsëritjes së alarmit nga 0 deri në 30 minuta

#### Vendosja e alarmit të temperaturës



Fig. 168




Fig. 169

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.



Fig. 170




Fig. 171

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Kufiri i poshtëm i temperaturës do të vendoset.




Fig. 172

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Kufiri i sipërm i temperaturës do të vendoset.





Fig. 173

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Koha e vonesës së alarmit do të vendoset.



# Përdorimi

Fig. 174

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Intervali i përsëritjes së alarmit do të vendoset.
- Alarmi i temperaturës do të vendoset.

## Shikimi i vlerave të vendosura të alarmit të temperaturës



Fig. 175




Fig. 176

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 177





Fig. 178

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Do të shfaqen vlerat e vendosura të alarmit të temperaturës.



## 6.2.27 Alarmi i derës

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni alarmin e derës. Alarmi i derës bie kur dera mbahet hapur shumë gjatë. Në gjendjen e dërgimit, alarmi i derës është i aktivizuar. Ju mund të vendoseni sesa gjatë lejohet të qëndrojë hapur dera, derisa të bjerë alarmi i derës.

Ju mund të vendosni vlerat e mëposhtme:

- 15 sekonda
- 30 sekonda
- 60 sekonda
- 90 sekonda
- 120 sekonda
- 150 sekonda
- 180 sekonda
- Fikur

## Vendosja e alarmit të derës



Fig. 179




Fig. 181 Shembull ilustrues: Ndërrimi i alarmit të derës nga 30 sekonda në 60 sekonda.

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Alarmi i derës vendoset.

## Çaktivizimi i alarmit të derës




Fig. 182




Fig. 183

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Alarmi i derës çaktivizohet.



## 6.2.28 Alarmi me dritë




Fig. 184




Fig. 185

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 186




Fig. 187

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Alarmi me dritë aktivizohet.

### Çaktivizimi i alarmit me dritë



Fig. 188



Fig. 189

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 190



Fig. 191

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Alarmi me dritë çaktivizohet.

### 6.2.29 Simulimi i alarmeve



#### Nisja e simulimit të alarmeve




Fig. 192




Fig. 193

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 194




Fig. 195

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Simulimi do të ekzekutohet.
- ▷ Pajisjet e lidhura të sigurisë duhet të veprojnë.



### 6.2.30 Historia e alarmeve

Ky cilësim mundëson një ekzaminim dhe fshirje të 10 alarmeve të fundit të shfaqura në pajisje.

Do të shfaqet sa më poshtë:

- Data dhe ora aktuale
- Alarmet aktive (të kuqe).
- Alarmet e kaluara që nuk janë ekzaminuar akoma paraqiten si **jo të konfirmuara (të kuq)**. Konfirmimi bëhet duke rrëshqitur me gisht në gabimin tjetër.
- Alarmet që janë ekzaminuar paraqiten si **të konfirmuara**.
- Fshirja e të gjitha alarmeve (edhe e alarmeve aktive dhe jo të konfirmuara).

#### Shikimi i historisë së alarmeve dhe fshirja e një alarmi



Fig. 196

-ose-

- Mbi simbolin tregues në buzën e poshtme të ekranit të statusit.

# Përdorimi




Fig. 197

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Do të kryhet ekzaminimi dhe fshirja e një alarmi.

## Shikimi i historisë së alarmeve dhe fshirja e të gjitha alarmeve



Fig. 198

### -ose-

- Mbi simbolin tregues në buzën e poshtme të ekranit të statusit.




Fig. 199

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Do të kryhet ekzaminimi dhe fshirja e të gjitha alarmeve.

## 6.2.31 Releja e alarmit

Ky cilësim mundëson përcjelljen e një ose të disa alarmeve te një marrës i jashtëm i alarmeve, i cili është i lidhur në pajisje.

Cilësimet që mund të zgjidhen janë ato më poshtë:

- Lloji i alarmit:
  - Alarmi i derës

- Alarmi i temperaturës
- Alarmi i derës dhe alarmi i temperaturës
- Të gjitha
- Konfirmimi:
  - **Po:** Alarmi përfundohet në pajisje dhe në marrësin e jashtëm të lidhur.
  - **Jo:** Alarmi konfirmohet/pranohet në pajisje dhe ai mbetet aktiv në marrës, derisa gabimi të jetë eliminuar.
- Përditësimi (i dukshëm vetëm kur te konfirmimi zgjidhet „Po“):
  - **Po:** Alarmi përsëritet.

**Alarmi i temperaturës** në varësi të kohës së vendosur (shihni 6.2.26 Alarmi i temperaturës) (Nëse koha e vonesës së alarmit është e vendosur në „0“, atëherë, as në relenë e alarmit nuk ndodh asnjë përsëritje e alarmit.)

**Alarmi i derës** pas 1 ose 4 minutash \* (shihni 6.2.27 Alarmi i derës)

- **Jo:** Alarmi konfirmohet/pranohet përgjithmonë.

## Aktivizimi i relesë së alarmit



Fig. 200




Fig. 201

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Releja e alarmit do të vendoset.

## 6.2.32 Modaliteti i demonstrimit

Modaliteti i demonstrimit është një funksion i veçantë për shitësit, që të mund të prezantojnë funksionet e pajisjes. Nëse e aktivizoni modalitetin e demonstrimit, atëherë të gjitha funksionet teknike të ftohjes çaktivizohen.

Nëse kur ndizni pajisjen shfaqet një "D" tek treguesi i statusit, kjo tregon se modaliteti i demonstrimit është aktivizuar më parë.

Nëse e aktivizoni modalitetin e demonstrimit dhe pastaj e çaktivizoni përsëri, pajisja rikthehet në cilësimet e fabrikës. (shihni 6.2.33 Rikthimi në cilësimet nga fabrika )

### Aktivizimi i modalitetit të demonstrimit



Fig. 202




Fig. 203

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Modaliteti i demonstrimit aktivizohet.
- Pajisja është fikur.
- Ndizni pajisjen. (shihni 4.14 Ndezja e pajisjes (Venia në punë herën e parë))
- Tek treguesi i statusit shfaqet "D".

### Çaktivizimi i modalitetit të demonstrimit





Fig. 204



Mesazhi (i kuq)	Shkaku	Zgjidhja
 Close the door	Mesazhi shfaqet kur dera mbahet hapur shumë gjatë.	Mbyllni derën. Prekni shkurt. Alarmi do të përfundojë. <b>Shënim</b> Koha se deri kur do të shfaqet mesazhi mund të konfigurohet. (shihni 6.2.27 Alarmi i derës )

Fig. 205

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Modaliteti i demonstrimit çaktivizohet.
- Pajisja është fikur.
- Ndizni pajisjen. (shihni 4.14 Ndezja e pajisjes (Venia në punë herën e parë))
- Pajisja rikthehet në cilësimet nga fabrika.

## 6.2.33 Rikthimi në cilësimet nga



Me këtë funksion ju i ktheni në cilësimet nga fabrika të gjitha rregullimet. Të gjitha rregullimet që keni kryer deri në atë moment, do të rikthehen në cilësimin e tyre fillostar.

### Ekzekutimi i rikthimit në gjendjen fillestare




Fig. 206




Fig. 207

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Pajisja rikthehet në gjendjen fillestare.
- Pajisja fiket.

### Shënim

Rikthimi në cilësimet nga fabrika në modalitetin me bateri: Rindzja është e mundur vetëm me tensionin e rrjetit elektrik.

- Rindzni pajisjen. (shihni 4.14 Ndezja e pajisjes (Venia në punë herën e parë))

## 6.3 Mesazhet

### 6.3.1 Paralajmërimet

Paralajmërimet shfaqen në mënyrë akustike nëpërmjet një tingulli sinjalizues dhe në mënyrë vizuale nëpërmjet një simboli në ekran. Tingulli sinjalizues forcohet dhe bëhet më i lartë derisa mesazhi të konfirmohet.

# Përdorimi

Mesazhi (i kuq)	Shkaku	Zgjidhja
 Temperature alarm	<b>Alarmi i temperaturës</b> <p>Mesazhi shfaqet kur temperatURA nuk përputhet me temperaturën e vendosur. ShFAQET pËR DIFERENCËN E TEMPERATURËS MUND TË JENË:</p> <p>FUTJA E USHQIMIT TË NGROHTË PËR FTOHJE. GJATË SISTEMIMIT DHE MARRJES SË USHQIMEVE, BREnda KA QARKULLUAR SHUMË AJËR I NGROHTË NGA DHOMA.</p> <p>ËSHTË NDËRPRERË ENERGJIA ELEKTRIKE PËR KOHË TË GJATË.</p>	<p>PREKNI SHKURT.</p> <p>DO TË SHFAQEN INFORMACIONET PËR GABIMIN DHE STATUSIN E PAJISJES.</p> <p>PREKNI SHKURT.</p> <p>DO TË SHFAQET TEMPERATURA MË E NGROHTË/MË E FTOHËTË, DATA DHE ORA.</p> <p>PREKNI SHKURT.</p> <p>DO TË SHFAQET EKRANI I STATUSIT.</p> <p>TEMPERATURA AKTUALE DHE SIMBOLI I ALARMIT PULSOJNË NË NGYJRË TË KUQE DERISA TË ARRIHET TEMPERATURA E VENDOSUR.</p> <p>KONTROLLONI CILËSINË E USHQIMIT PËR FTOHJE.</p>
 Device failure	<b>Gabimi</b> <p>PAJISJA KA PËSUAR DEFECT, KA NJË GABIM TË PAJISJES OSE NJË PJESË E PAJISJES SHFAQ NË DEFECT.</p>	<p>KALONI USHQIMET PËR FTOHJE NË PAJISJE Tjetër.</p> <p>PREKNI SHKURT.</p> <p>DO TË SHFAQET KODI I GABIMIT (P.SH. BT021).</p> <p>PREKNI SHKURT.</p> <p>NËSE KA, SHFAQET EDHE KODI Tjetër I GABIMIT OSE</p> <p>SHFAQET EKRANI I STATUSIT ME SIMBOLIN E GABIMIT QË PULSON.</p> <p>RRESHQITJA E GISHTIT OSE PREKJA NË EKRAN TREGON PËRSËRI KODIN(ET) E GABIMIT.</p> <p>MBANI SHËNIM KODIN(ET) E GABIMEVE DHE KONTAKTONI SHËRBIMIN PËR Klientin. (shihni 9.3 Shërbimi për klientin)</p>
	<p>MESAZHI KËSHILLON PËR NJË PROCES SHKRIRJEJE TË PAPLANIFIKUAR. PËR SHEMBULL, SERPENTINA KA ZËNË NË MËNYRË TË PAZAKONTË SHUMË AKULL PËR SHKAK TË HAPJAVE TË GJATA TË DERËS DHE KOHËZGJATJA E SHKRIRJES NUK MJAFTON MË.</p>	<p>PREKNI SHKURT.</p> <p>DO TË SHFAQET <b>DEFR.MAX.</b></p> <p>PREKNI SHKURT.</p> <p>SHFAQET EKRANI I STATUSIT ME SIMBOLIN E GABIMIT QË PULSON.</p> <p>RRESHQITJA E GISHTIT OSE PREKJA NË EKRAN TREGON PËRSËRI MESAZHIN.</p> <p>KALONI USHQIMET PËR FTOHJE NË PAJISJE Tjetër DHE SHKRINI PAJISJEN ME DORË. SI ALTERNATIVË, SHKRIRJA MUND TË NISET MANUALISHT. (SHIHNI 6.2.23 SHKRIRJA)</p> <p>PREKJA E GJATË FIK SIMBOLIN E GABIMIT QË PULSON. NËSE MESAZHI SHFAQET NË MËNYRË TË PËRSËRITUR DHE AI NUK LIDHET ME SHFAQET E NJOHURA, ATËHERË KONTAKTONI ME SHËRBIMIN PËR Klientin. (shihni 9.3 Shërbimi për klientin)</p>

Mesazhi (i kuq)	Shkaku	Zgjidhja
 Power failure	Mesazhi shfaqet pas ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike. Ndërfaqja e përdorimit vazhdon të punojë në modalitetin me bateri. Të gjitha funksionet, përvèç ftohjes dhe ndriçimit, mbeten aktive.	Prekni shkurt. Shfaqet gjendja e karikimit të baterisë, informacionet pér gabimin dhe statusin e pajisjes Prekni shkurt. Do të shfaqen temperatura më e ngrohtë, periudha kohore dhe numri i ndërprerjeve të energjisë elektrike. Prekni shkurt. Do të shfaqet ekran i statusit. Temperatura aktuale dhe simboli i alarmit pulsojnë në ngjyrë të kuqe derisa të arrihet temperatura e vendosur. Kontrolloni cilësinë e ushqimit pér ftohje.
 Defrost error	Shkrirja automatike nuk po funksionon pa probleme. 5 ciklet e fundit të shkrirjes kanë rezultuar jo të suksesshém.	Prekni shkurt. Alarmi do të përfundojë. Kontaktoni me shërbimin pér klientin. (shihni 9.3 Shërbimi pér klientin)
 WiFi error	Lidhja WLAN është shkëputur.	Kontrolloni lidhjen. Prekni shkurt. Alarmi do të përfundojë.
 WWW error	Mesazhi shfaqet kur nuk ka asnjë lidhje me internetin nëpërmjet WLAN.	Kontrolloni lidhjen. Prekni shkurt. Alarmi do të përfundojë.
 LAN error	Lidhja LAN është shkëputur.	Kontrolloni lidhjen dhe kabllon e rrjetit. Prekni shkurt. Alarmi do të përfundojë.
 WWW error	Mesazhi shfaqet kur nuk ka asnjë lidhje me internetin nëpërmjet rrjetit LAN.	Kontrolloni lidhjen. Prekni shkurt. Alarmi do të përfundojë.
 Battery status	Gjendja e karikimit të baterisë së pajisjes e ulët (ka mbetur maksimumi 20%).	Rivendosni furnizimin me energji të pajisjes nga rrjeti elektrik dhe pas 12 orësh kontrolloni njëse gjendja e karikimit është rritur. Në të kundërt, kontaktoni me shërbimin pér klientin (shihni 9.3 Shërbimi pér klientin) ose ndërroni baterinë. (shihni 8.4 Ndërrimi i baterisë së pajisjes) Prekni shkurt. Alarmi do të përfundojë.

### 6.3.2 Kujtesat

Kujtesat shfaqen atëherë kur nevojitet që të bëhet diçka. Ato shfaqen në mënyrë akustike nëpërmjet një tingulli sinjalizues dhe në mënyrë vizuale nëpërmjet një simboli në ekran. Eliminimi i mesazhit bëhet nëpërmjet shtypjes së butonit të konfirmimit.

Mesazhi (i verdhë)	Shkaku	Zgjidhja
 Maintenance	Mesazhi shfaqet kur kapërcehet koha në kohëmatësin e intervalit të caktuar të mirëmbajtjes.	Prekni shkurt. Kujtesa do të përfundojë. <b>Shënim</b> Intervali i mirëmbajtjes mund të konfigurohet (shihni 6.2.11 Kujtesa e intervalit të mirëmbajtjes ).
 Min./max. memory	Mesazhi shfaqet kur memoria e regjistrimit të temperaturës është plot (999 orë).	Prekni shkurt. Kujtesa do të përfundojë. Të dhënati më të vjetra zëvendësohen nga më të rejet. <b>Shënim</b> Regjistrimi i temperaturës mund të rivendoset nga fillimi. (shihni 6.2.4 Regjistrimi i temperaturave )
 Alarm history	Mesazhi shfaqet kur ka më shumë se 10 mesazhe alarmi të pakonfirmuara.	Prekni shkurt. Kontrolloni mesazhet. Kujtesa do të përfundojë.
 Manually opened	Mesazhi shfaqet kur dera e mbyllur në mënyrë elektronike hapet manualisht.	Mbyllni derën. Prekni shkurt. Kujtesa do të përfundojë.
Hapur manualisht		

## 7 Pajisjet

### 7.1 Brava e sigurisë

Pajisja është e pajisur me një bravë sigurie.

Funkcionet e mundshme:

- Mbyllni dhe hapni bravën e derës me kodin e derës. (shihni 6.2.6 Bllokimi i derës )
- Aktivizoni dhe çaktivizoni bllokimin automatik të derës. (shihni 6.2.6 Bllokimi i derës )
- Komandimi nëpërmjet telekomandës. (shihni 6.2.10 Telekomanda )




Fig. 209

- Futni brenda nga lart çelësin e zhbllokimit të emergjencës Fig. 209 (1), kapeni te brava dhe tërhikeni lart Fig. 209 (2).
- Brava shkyçet. Tani dera mund të hapet.

#### 7.1.1 Zhbllokimi i emergjencës

Në rast të ndërprerjes së energjisë, hapja e derës është e mundur me anë të çelësit të zhbllokimit të emergjencës.




Fig. 208

- Hiqni kapakun mbulues.

### 7.2 Telekomanda

Telekomanda mundëson kyçjen dhe shkyçjen e bravës së derës nga distanca.

Përpara përdorimit, duhet që ajo të lidhet me pajisjen. (shihni 6.2.10 Telekomanda )

Bateria mund të ndërrohet. (shihni 8.4 Ndërrimi i baterisë së pajisjes)




Fig. 210

(1) Kyçja e bravës  
(2) Shkyçja e bravës

(3) Treguesi LED i statusit  
(4) Vrima e fiksimit

## 7.2.1 Përdorimi i telekomandës

- ▶ Shtypni butonin Fig. 210 (1) në telekomandë.
- ▷ Brava kyçet. Dera nuk mund të hapet.
- ▶ Shtypni butonin Fig. 210 (2) në telekomandë.
- ▷ Brava shkyçet. Tani dera mund të hapet.
- ▶ Treguesi LED i statusit Fig. 210 (3) jep një reagim vizual kur shtypet një buton.
- ▶ Vrima Fig. 210 (4) për kapjen e telekomandës, për shembull, në një varëse çelësash.

## 7.3 Sensorët

Pajisja mund të plotësohet me sensorët e mëposhtëm për monitorimin e temperaturës:

- Sensori C
- Sensori P

### 7.3.1 Sensori C (sensori i kontrollit)

Sensori C është i instaluar në mënyrë të përhershme dhe rregullon temperaturën e brendshme të pajisjes. Nëse nevojitet, sensori C mund të kalibrohet. (shihni 6.2.25 Kalibrimi i sensorit )

### 7.3.2 Sensori P (sensori referencë)

Sensori P është i instaluar në mënyrë të përhershme në hapësirën e brendshme, për të regjistruar në mënyrë specifike dhe për të monitoruar temperaturën në atë vend. Nëse temperatura e vendosur në këtë vend kapërcehet, sensori aktivizon një alarm. Nëse nevojitet, sensori P mund të kalibrohet. (shihni 6.2.25 Kalibrimi i sensorit )

## 7.4 Informacioni i sensorit



Ky funksion bën të mundur zgjedhjen midis sensorit C ose sensorit P.

Sigurohuni që është përbushur kushti i mëposhtëm:

- Sensori P është i lidhur në pajisje. (shihni 7.5 Ndërfaqet e lidhjes)

### 7.4.1 Zgjedhja e sensorit C



Fig. 211

- ▶ Rrëshqitni me gisht majtas ose djathtas derisa të shfaqet funksioni përkatës.




Fig. 212

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Sensori C do të zgjidhet.

### 7.4.2 Zgjedhja e sensorit P




Fig. 213

- ▶ Rrëshqitni me gisht majtas ose djathtas derisa të shfaqet funksioni përkatës.




Fig. 214

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Sensori P do të zgjidhet.

## 7.5 Ndërfaqet e lidhjes

Në anën e pasme të pajisjes ekzistojnë mundësi të ndryshme për lidhjen e saj.

# Mirëmbajtja




Fig. 215

## Shënim

Fishat e lidhjes janë të siguruara me vida. Që të mund të hiqni fishat, lironi vidat majtas dhe djathtas.




Fig. 216

(4) Lidhja për sensorin P

(2) Ndërfaqja e lidhjes së USB

(3) Dalja e alarmit me kontakt pa potencial

(4) Ndërfaqja e lidhjes së rrjetit LAN

## 7.5.1 Dalja e alarmit me kontakt pa potencial



### PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi nga goditja elektrike!

► Lidhja e pajisjes në një aparaturë të jashtme alarmi lejohet të bëhet vetëm nga staf teknik i trajnuar!

Këto tre kontakte mund të përdoren për të lidhur një aparaturë alarmi vizuale ose akustike. Lidhja është projektuar përmaksimumi **30 V (DC) - 8 A** nga një burim i sigurt tensioni të ulët SELV (**rryma minimale 150 mA**).




Fig. 217

(1) NO (normally open)

Lidhje përditësinjalizuese, e cila është aktive në funksionim normal ose kur pajisja është e fikur.

(3) NC (normally closed)

Lidhje përditës alarmi ose përpajisje alarmi akustik, e cila është aktive në rast alarmi ose të mungesës së furnizimit me energji.

(2) COM (common) Burimi i jashtëm i tensionit

## 7.5.2 Lidhja për sensorin P




Fig. 218

(1) IN+ (Linja e matjes +)

(2) IN- (Linja e përbashkët e kthimit -)

(3) FORCE (Ushqimi +)

# 8 Mirëmbajtja

## 8.1 Plani i mirëmbajtjes

Për të ruajtur funksionimin e pajisjes duhen kryer rregullisht punime mirëmbajtjeje.



### VINI RE

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga punimet joprofessionale të mirëmbajtjes!

Lëndime të personave dhe dëme materiale.

► Punimet e mirëmbajtjes lejohen të bëhen vetëm nga staf teknik i trajnuar.



### PARALAJMËRIM

Rrezik përlidhje të shkurtër nga pjesët që përçojnë energji elektrike!

Goditje elektrike ose dëmtim i pjesëve elektronike.

► Fikni pajisjen.

► Hiqni spinën elektrike nga priza ose fikni siguresën.

## Shënim

Për mirëmbajtjen mund të aktivizohet një funksion kujtese. (shihni 6.2.11 Kujtesa e intervalit të mirëmbajtjes )

## Shënim

Këshillohet që të krijohet një historik i mirëmbajtjes, në të cilin të dokumentohen të gjitha punimet e kryera (riparime, kontolle).

## Shënim

Liebherr këshillon një mirëmbajtje vjetore. Për ofertë individuale, drejtohuni te kujdesi për klientin (shihni 9.3 Shërbimi për klientin).

Komponenti	Detyra	Intervali i mirëmbajtjes
Pjesët prej llamarine	Kontrolloni për dëmtime dhe për korrozion. Ndërrimi i pjesëve të dëmtuara: (shihni 9.3 Shërbimi për klientin)	Çdo vit

Komponenti	Detyra	Intervali i mirëmbajtjes
Dera, menteshat	Kontrolloni nivelimin (shihni 4.12 Nivelimi i derës) , lëvizjen dhe qëndrimin e fiksuar.	Çdo vit
Brava, doreza e derës *	Kontrolloni lëvizjen e lehtë dhe qëndrimin e fiksuar.	Çdo vit
Guarnicioni i derës	Kontrolloni për dëmtim, konsumim dhe qëndrimin e fiksuar. Një guarnicion zëvendësues për derën mund të blihet te shërbimi për klientin (shihni 9.3 Shërbimi për klientin).	Çdo vit
Sensori	Kalibroni sensorin. (shihni 6.2.25 Kalibrimi i sensorit )	Çdo vit
Vrima e depërtimit e sensorit	Kontrolloni nëse materiali izolues është i padëmtuar.	Çdo vit
Bateria	Ndërroni baterinë e pajisjes. Një bateri zëvendësuese mund të blihet te kujdesi për klientin. (shihni 8.4 Ndërrimi i baterisë së pajisjes)	5 deri në 10 vjet
Sipërfaqt	Pastrimi (shihni 8.3 Pastrimi i pajisjes)	Rekomandimi: çdo muaj ose sipas nevojës ose rrethanave në vendin e instalimit
Sipërfaqt	Dezinfektimi	Rekomandimi: çdo muaj ose sipas nevojës ose rrethanave në vendin e instalimit
Vendi i instalimit, pajisja	Dekontaminimi Pajisja është e përshtatshme për dekontaminim të ambientit me peroksid hidrogjeni $H_2O_2$ . Për këtë nuk duhen tejkaluar vlerat e specifikimeve të përdorimit të treguara më poshtë: Përqendrimi maksimal 250 ppm. Lagështia maksimale 85%. Temperatura maksimale e lejuar e ambientit sipas klasës së klimës. (shihni 1.4 Fusha e përdorimit e pajisjes)	Rekomandimi: sipas nevojës ose rrethanave në vendin e instalimit, maksimumi 2 herë çdo vit
Kanalet e ajrit të ventilatorit	Pastrimi	Çdo vit
Releja e alarmit Sensori	Kontrolloni lidhjet me fisha për qëndrimin e fiksuar.	Çdo vit
Kordoni elektrik	Kontrolloni për dëmtim.	Çdo vit ose kur ndërrohet vendi
Profili kundër përbysjes	Kontrolloni aftësinë funksionale dhe qëndrimin e fiksuar.	Çdo vit ose kur ndërrohet vendi
Këmbët me rregullim/rulet	Kontrolloni aftësinë funksionale, për dëmtim dhe për qëndrimin e fiksuar. Ndërroni pjesët e dëmtuara. (shihni 9.3 Shërbimi për klientin)	Çdo vit

## 8.2 Shkrirja e pajisjes



### PARALAJMËRIM

Shkrirja e papërshtatshme e pajisjes!

Lëndime dhe dëmtime.

- Për të shpejtuar procesin e shkrirjes mos përdorni asnjë pajisje tjeter mekanike ose ndonjë mënyrë tjeter përvëç atyre të rekomanuara nga prodhuesi.
- Mos përdorni asnjë pajisje ngrohëse elektrike ose pajisje pastrimi me avull, flakë të zbuluara ose spërkatës për shkrirje.
- Mos e hiqni akullin me objekte të mprehta.

Për të ruajtur funksionalitetin e pajisjes, ne rekomandojmë shkrirjen e saj në rast të formimit të lartë të akullit. Për formimin e akullit brenda pajisjes, kanë shumë rëndësi vendi i instalimit (p.sh. nga lagështia e lartë e ajrit), cilësimet e vendosura në pajisje dhe sjellja jo e saktë e përdoruesit.

Shkrirja manuale:

- Fikni pajisjen. (shihni 6.2.2 Ndezja dhe fikja e pajisjes )
- Hiqni spinën elektrike nga priza.
- Kaloni ushqimet për ftohje në pajisje tjeter.
- Lëreni hapur derën e pajisjes gjatë procesit të shkrirjes.
- Mblidhni me një leckë ujin e mbetur të shkrirjes dhe fshini pajisjen.

## 8.3 Pastrimi i pajisjes

### 8.3.1 Parapërgatitja



#### PARALAJMËRIM

Rrezik për lidhje të shkurtër nga pjesët që përçojnë energji elektrike!

Goditje elektrike ose dëmtim i pjesëve elektronike.

- **Fikni pajisjen.**

- Hiqni spinën elektrike nga priza ose fikni siguresën.



#### PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri

- Mos dëmtoni qarkun e ftohjes.

- Zbrasni pajisjen.
- Hiqni spinën elektrike.
- Ndiqni udhëzimet për transportin e pajisjes. (shihni 4.3 Transportimi i pajisjes)

### 8.3.2 Pastrimi i trupit

#### KUJDES

Pastrimi i gabuar!

Dëmtime në pajisje.

- Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
- Mos përdorni sfungjer gërryes ose gjërvishës ose lesh teli metalik.
- Mos përdorni asnje mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.



#### PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga avulli i nxehtë!

Avulli i nxehtë mund të shkaktojë djegie dhe të dëmtojë sipërfaqet.

- Mos përdorniasnje pajisje pastrimi me avull!

#### KUJDES

Rrezik dëmtimi nga lidhja e shkurtër!

- Gjatë pastrimit të pajisjes bëni kujdes që uji i pastrimit të mos depërtojnë te komponentët elektrikë.

- Fshini trupin nga jashtë me një leckë të butë e të pastër. Në rast ndotjeje të fortë, përdorni ujë të vakët me pastrues neutral. Sipërfaqet prej xhami mund të pastrohen gjithashtu me pastrues për xhamë.
- Pastroni rregullisht spiralet e serpentinës së jashtme. Nëse spiralet e serpentinës së jashtme nuk pastrohen, kjo gjë çon në ulje të ndjeshme të efikasitetit të pajisjes.

### 8.3.3 Pastrimi i hapësirës së brendshme



#### PARALAJMËRIM

Rrezik për lidhje të shkurtër nga pjesët që përçojnë energji elektrike!

Goditje elektrike ose dëmtim i pjesëve elektronike.

- **Fikni pajisjen.**

- Hiqni spinën elektrike nga priza ose fikni siguresën.



#### PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga avulli i nxehtë!

Avulli i nxehtë mund të shkaktojë djegie dhe të dëmtojë sipërfaqet.

- Mos përdorniasnje pajisje pastrimi me avull!

#### KUJDES

Pastrimi i gabuar!

Dëmtime në pajisje.

- Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
- Mos përdorni sfungjer gërryes ose gjërvishës ose lesh teli metalik.
- Mos përdorniasnje mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

#### Shënim

Mos dëmtoni ose mos hiqni etiketën e parametrave në brendësi të pajisjes. Etiketa e parametrave është e rëndësishme për shërbimin për klientin. (shihni 9.3 Shërbimi për klientin)

- Hapni derën.
- Zbrasni pajisjen.
- Lani hapësirën e brendshme dhe pjesët me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh. Mos përdorniasnje produkt pastrimi të ashpër apo që përmban acid, si dhe mos përdorni tretës kimikë.

### 8.3.4 Pas pastrimit

- Thani pajisjen dhe pjesët përshtatëse duke i fërkuar.
- Lidhni pajisjen dhe ndizeni.  
Kur temperatura të jetë mjafqimet e ftohtë:
  - Futni brenda ushqimet për ftohje.
  - Përsëritni pastrimin rregullisht.
- Pastroni dhe fshini pluhurin të paktën një herë në vit të pajisjes frigoriferike me shkëmbyes nxehtësie (rrjeta metalike në pjesën e pasme të pajisjes).

## 8.4 Ndërrimi i baterisë së pajisjes

Bateria e pajisjes shërben në rast të ndërprerjes së energjisë për regjistrimin e ecurisë së temperaturave, të mesazheve të alarmeve dhe shërbimit, si dhe për të shfaqur mesazhet e alarmit në ekran për reth 12 orë. Në vërien në punë herën e parë, bateria mund të kërkojë deri në 24 orë që të karikohet dhe të jetë plotësisht funksionale.

Një bateri zëvendësuese mund të blihet te kujdesi për klientin (shihni 9.3 Shërbimi për klientin).

### 8.4.1 Ndërrimi i baterisë



#### PARALAJMËRIM

Rrezik për lidhje të shkurtër nga pjesët që përçojnë energji elektrike!

Goditje elektrike ose dëmtim i pjesëve elektronike.

- **Fikni pajisjen.**

- Hiqni spinën elektrike nga priza ose fikni siguresën.




Fig. 219

- Lironi vidën dhe hiqni kapakun mbulues në anën e pasme të pajisjes Fig. 219 (1).
- Shkëputni baterinë dhe nxirreni jashtë Fig. 219 (2).
- Montoni baterinë zëvendësuese.
- Mbyllni kapakun mbulues dhe shtrëngoni vidën.
- Futni sërish në prizë kordonin e lidhjes elektrike.

## Shënim

- Bateria duhet t'i nënshtrohet trajtimit të diferencuar të mbetjeve dhe ajo duhet hedhur në mënyrën e duhur dhe të rregullt, në përputhje me rregulloret dhe ligjet lokale në fuqi. **Kurrë mos i dëmtoni ose mos i lidhni shkurt bateritë në asnjë mënyrë!**

## 8.5 Ndërrimi i baterisë së telekomandës




Fig. 220

Furnizimi me energji i telekomandës bëhet përmes një baterie të tipit CR 2032 me 3 V Fig. 220 (2), e cila bilihet në një dyqan.

### 8.5.1 Ndërrimi i baterisë

- Lironi vidën Fig. 220 (1) në pjesën e pasme të telekomandës.
- Hiqni pjesën e pasme.
- Foleja e baterisë është e hapur.
- Ndërroni baterinë.

- Mbyllni folenë e baterisë.
- Mbërtheni vidën.

## Shënim

- Bateria duhet t'i nënshtrohet trajtimit të diferencuar të mbetjeve dhe ajo duhet hedhur në mënyrën e duhur dhe të rregullt, në përputhje me rregulloret dhe ligjet lokale në fuqi. **Kurrë mos i dëmtoni ose mos i lidhni shkurt bateritë në asnjë mënyrë!**

## 9 Ndihma për klientin

### 9.1 Të dhënat teknike

#### Diapazoni i temperaturave

Ngrirja	-9 °C deri në -35 °C
---------	----------------------

#### Ngarkesa maksimale, rafitet me rrjetë<sup>A)</sup>

Ngarkesa maksimale, rafeti i ndërmjetëm me rrjetë <sup>A)</sup> (shihni 4.15 Vendosja e pjesëve)	Ngarkesa maksimale, rafeti i ndërmjetëm me rrjetë <sup>A)</sup> (shihni 4.15 Vendosja e pjesëve)
--	--

60 kg	10 kg
-------	-------

<sup>A)</sup> Në rast ngarkese të madhe mund të ndodhë një deformim i lehtë i rafteve mbajtëse.

#### Vëllimi i shfrytëzueshëm maksimal

Shihni vëllimin e shfrytëzueshëm në etiketën e parametrave. (shihni 1.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve)

#### Ndriçimi

Klasa e eficencës së energjisë A)	Burimi i dritës
Ky produkt përmban një ose më shumë burime drite të klasës së eficencës së energjisë "G"	LED

A) Pajisja mund të ketë burime drite me klasa të ndryshme të eficencës së energjisë. Këtu jepet klasa e eficencës më të ulët të energjisë.

#### Specifikimet e frekuencës së WLAN

Brezi i frekuencave	2,4 GHz
Fuqia maksimale e rezatuar	<100 mW
Qëllimi i përdorimit i pajisjes me radiovalë	Lidhja në rrjetin lokal WLAN për komunikimin e të dhënavë

#### Kushtet e instalimit

Shkalla e ndotjes (mjedisi përreth pajisjes)	PD2
Temperatura e ambientit	+10 °C deri në +35 °C
Lagështia maksimale relative e ambientit	75%, jo kondensuese
Lartësia maksimale e funksionimit të pajisjes (m mbi nivelin e detit)	2000 m 1500 m (derë xhami)

#### Vlerat elektrike

Tensioni nominal	220-240 V ~
Frekuencia	50/60 Hz
Vlera e lidhjes	4,0 A

# Ndihma për klientin

Vlerat elektrike	
Luhatjet maksimale të rrjetit	+/-10%
Kategoria e tensionit të lartë	II

Të dhënat sipas DIN 13277 të matura në temperaturën referencë të ambientit prej +25 °C

Modeli SFPvh	Konsumi i energjisë (kWh/24h)	Rritja e temperaturës pasi është ndërprerë energjia (min)	Homogeniteti i temperaturës (°K)	Konstantja e temperaturës (°K)
1402	5,870	186 A)	1,5 B)	4,1 B)
6501	3,271	187 A)	1,9 B)	4,2 B)
8401	3,505	193 A)	2,1 B)	4,4 B)

A) Ngrohja e trupit referencë: nga -35 °C në -10 °C / Trupi referencë: Enë qelqi 50 ml e mbushur me 50 ml isopropanol

B) Matur në temperaturën e kërkuar referencë prej -35 °C

Bateria e pajisjes	
Tipi	1S2P/NCR 18650BF
Tensioni nominal	3,6 V DC
Kapaciteti	6,7 Ah

## 9.2 Defektet teknike

Pajisja juaj është projektuar dhe prodhuar në mënyrë të tillë që të garantohet siguria e funksionimit dhe jetëgjatësia e madhe. Por megjithatë kur gjatë përdorimit shfaqet një problem, verifikoni nëse problemi është shkaktuar si rezultat i një gabimi në përdorim. Në këtë rast, duhet të merrni në konsideratë kostot e riparimit, edhe gjatë periudhës së garancisë.

Problemet që jepen në vijim mund t'i eliminoni vetë.

### 9.2.1 Funksioni i pajisjes

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
<b>Pajisja nuk punon.</b>	→ Pajisja nuk është e ndezur.	► Ndizni pajisjen.
	→ Spina nuk është futur saktë në prizën elektrike.	► Kontrolloni spinën.
	→ Siguresa në prizën elektrike nuk është në rregull.	► Kontrolloni siguresën.
	→ Shkëputje e energjisë elektrike	► Mbani të myllur pajisjen. ► Hapja e derës është e mundur me anë të çelësit të zbllokimit të emergjencës. (shihni 7.1 Brava e sigurisë) ► Nëse nevojitet, kaloni ushqimet përfthohje/ngrirje në një frigorifer ftohës/ngrirës të pavarur, nëse shkëputja e energjisë elektrike zgjat shumë.
	→ Fishë e frigoriferit nuk është futur mirë në pajisje.	► Kontrolloni fishën e frigoriferit.
<b>Temperatura nuk është mjaftueshëm e ftohtë.</b>	→ Dera e pajisjes nuk është myllur siç duhet.	► Mylli derën e pajisjes.
	→ Qarkullimi i ajrit dhe ajrimi nuk është i mjaftueshëm.	► Mbani të lirë dhe pastroni rrjetën e ajrimit.
	→ Temperatura e ambientit është shumë e lartë.	► Bëni kujdes për kushtet e duhura të ambientit: (shihni 1.4 Fusha e përdorimit e pajisjes)
	→ Pajisja është hapur shumë shpesht ose përkohë të gjatë.	► Pritni përfshirë nëse temperatura e kërkuar do të rivendoset vetveti. Nëse jo, kontaktoni me shërbimin përklientin. (shihni 9.3 Shërbimi përklientin)
	→ Temperatura është vendosur gabim.	► Vendosni temperaturë më të ftohtë dhe kontrollojeni pas 24 orësh.
	→ Pajisja ndodhet shumë pranë një burimi nxehësie (sobë, kalorifer etj.).	► Ndryshoni vendin e pajisjes ose të burimit të nxehësie.
<b>Telekomanda nuk funksionon.</b>	→ Bateria e telekomandës është shkarkuar.	► Ndërroni baterinë.
	→ Lidhja me valë me pajisjen është shumë e dobët.	► Zvogëloni distancën me pajisjen.
	→ Telekomanda nuk është çiftuar.	► Çiftoni nga e para telekomandën: (shihni 6.2.10 Telekomanda )
	→ Telekomanda ka defekt.	► Kontaktoni me shërbimin përklientin. (shihni 9.3 Shërbimi përklientin)

## 9.3 Shërbimi për klientin

Fillimisht provoni nëse mund ta eliminoni vetë defektin. Nëse nuk ia dilni dot, kontaktoni me shërbimin për klientin. Adresën e gjeni në broshurën bashkëlidhur „Shërbimi i Service“ ose në faqen e internetit [home.liebherr.com/service](http://home.liebherr.com/service).

### PARALAJMËRIM

Riparim jo profesional!  
Lëndime.

- ▶ Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje dhe në kordonin e lidhjes elektrike, të cilat nuk përmenden në mënyrë specifike (shihni 8 Mirëmbajtja), duhen kryer vetëm nga kujdesi për klientin.
- ▶ Ndërroni kordonin e dëmtuar të lidhjes elektrike vetëm te prodhuesi ose nga shërbimi i tij për klientin ose te një person me kualifikim të ngjashëm.
- ▶ Në pajisjet me spinë frigoriferi, ndërrimi lejohet të bëhet nga klienti.

### 9.3.1 Kontakti me shërbimin për klientin

Sigurohuni që keni gati informacionet e mëposhtme të pajisjes:

- Emërtimi i pajisjes (Modeli dhe indeksi)
- Nr. i shërbimit (Shërbimi)
- Numri i serisë (S-Nr.)
- ▶ Hapni informacionet e pajisjes nëpërmjet ekranit (shihni 6.2.20 Informacioni i pajisjes).
- ose-
- ▶ Merrni informacionet e pajisjes nga etiketa e parametrave. (shihni 9.4 Etiketa e parametrave)
- ▶ Mbani shënim informacionet e pajisjes.
- ▶ Njoftoni shërbimin për klientin: Komunikojini defektin dhe informacionet e pajisjes.
- ▶ Kjo bën të mundur një shërbim të shpejtë dhe të fokusuar.
- ▶ Ndiqni instrukzionet e tjera të shërbimit për klientin.

## 9.4 Etiketa e parametrave

Etiketa e parametrave ndodhet në anën e brendshme të pajisjes. Shihni kapitullin Pasqyra e pajisjes.




Fig. 221

(1) Emërtimi i pajisjes  
(2) Nr. i shërbimit

(3) Numri i serisë

## 10 Nxjerrja jashtë pune

- ▶ Zbrazni pajisjen.
- ▶ Fikni pajisjen.
- ▶ Hiqni spinën elektrike nga priza elektrike.
- ▶ Nëse nevojitet, hiqni fishën e frigoriferit: Nxirri fishën e frigoriferit nga priza në pajisje dhe njëkohësisht lëvizeni majtas dhe djathtas.
- ▶ Pastroni pajisjen. (shihni 8.3 Pastrimi i pajisjes)
- ▶ Nëse ekziston: Hiqni kapakët mbulues dhe izolimin e vrimës së depërtimit të sensorit për të evituar formimin e mykut.

- ▶ Lëreni derën hapur që të mos krijohen erëra të këqija.

### Shënim

Dëmtime në pajisje dhe defekte në funksionim!

- ▶ Pas nxjerrjes jashtë pune vendoseni pajisjen në ruajtje vetëm në temperaturat e lejuara të ambientit midis -10 °C dhe +50 °C.

## 11 Hedhja/asgjësimi

### 11.1 Përgatitja e pajisjes për asgjësimin



Në disa pajisje Liebherr përdor bateri. Në BE, për arsyet e mbrojtjes së mjedisit, ligjvënesi e ka detyruar përdoruesin fundor që t'i heqë këto bateri përpara hedhjes së pajisjeve të vjetra. Nëse pajisja juaj përmban bateri, në pajisje është vendosur edhe udhëzimi përkates përkates qëllim.


Llambat Në rast se ju mund t'i hiqni vetë llambat pa i dëmtuar ato, çmontoni gjithashu edhe llambat përpara hedhjes së pajisjes.

- ▶ Nxirreni pajisjen jashtë pune.
- ▶ Pajisjet me bateri: Hiqni bateritë. Shihni kapitullin Mirëmbajtja.
- ▶ Nëse është e mundur: Çmontoni llambat pa i dëmtuar ato.

### 11.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike



Pajisja përmban ende materiale të vlefshme dhe duhet dërguar në grumbullimin e vecuar, i ndryshëm nga mbetjet e paklasifikuara shtëpiake.



Hidhini bateritë të ndara më vete nga pajisja e vjetër. Përkëtë, mund t'i ktheni pa pagesë bateritë në dyqan ose në pikat e riciklimit dhe të mbledhjes së materialeve të ripërdorshme.

Llambat

Hidhini llambat e çmontuara në pikat përkatese të grumbullimit.

Për Gjermaninë:

Ju mund ta hidhni pajisjen pa pagesë në pikat lokale të riciklimit dhe të mbledhjes së materialeve të ripërdorshme, në koshat e klasës 1. Kur blihet një frigorifer ftohës / ngrirës i ri dhe sipërfaqja e dyqanit është > 400 m<sup>2</sup>, dyqani pranon gjithashu dorëzimin e pajisjes së vjetër pa pagesë.



### PARALAJMËRIM

Gaz ftohës dhe vaj që del jashtë!

- Zjarr. Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rrjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkates për kontakt me një burim nxehësie të jashtëm.
- ▶ Mos dëmontri tubacionet e qarkut të gazit ftohës dhe kompresorin.

## **Informacionet shtesë**

---

- ▶ Ndiqni udhëzimet për transportin e pajisjes.  
(shihni 4.3 Transportimi i pajisjes)
- ▶ Transportoni pajisjen pa e dëmtuar atë.
- ▶ Hidhni bateritë, llambat dhe pajisjen sipas udhëzimeve të përshkruara më lart.

## **12 Informacionet shtesë**

Informacione të tjera për kushtet e garancisë gjeni në broshurat e shërbimit bashkëngjitur ose në internet në adresën <https://home.liebherr.com>.

# Udhëzuesi i shkurtër për përdorimin e përditshëm

Në rast defekti të pajisjes informoni: \_\_\_\_\_

Emërtimi i modelit /  
Numri i inventarit: \_\_\_\_\_

## Udhëzuesi i shkurtër për përdorimin e përditshëm

Informacione lidhur me përdorimin e këtij udhëzuesi të shkurtër:

- Ky udhëzues i shkurtër nuk zëvendëson manualin e plotë të përdorimit dhe nuk zëvendëson trajnimin në pajisje.
- Ky udhëzues i shkurtër është një ndihmësë për përdorimin e përditshëm dhe për veprimin me pajisjen.
- Lexoni manualin e plotë të përdorimit, si dhe udhëzimet e sigurisë që ai përmban.

Ky udhëzues i shkurtër vlen për: SFPvh 14../65../84..



Ju mund ta hapni manualin e plotë të përdorimit nëpërmjet kodit QR:



### Përdorimi i parashikuar

Ky frigorifer ngrirës për laboratorët është i përshtatshëm përuajtjen profesionale të produkteve në temperaturë midis -9 °C dhe -35 °C.

### Përdorimi i gabuar i parashikueshëm

Mos e përdorni pajisjen për përdorimet e mëposhtme:

- Ruajtja dhe ftojja e:
  - substancave kimike të paqëndrueshme, që marrin flakë ose irrituese
  - gjakut, plazmës ose e lëngjeve të tjera të trupit, përqëllimet e infuzionit, të aplikimit ose të futjes në trupin e njeriut
- Përdorimi në ambiente potencialisht shpërthyese
- Përdorimi në ambient të jashtëm ose në vende me lagështi dhe ku spërkatet nga uji

### Gjatë vendosjes në ruajtje mbani parasysh:

- ❑ Zhvendosni raftet me rrjetë sipas lartësisë së nevojshme.
- ❑ Mbani parasysh ngarkesën maksimale.
- ❑ Mbushni pajisjen kur të jetë arritur temperatura e ruajtjes (respektimi i zinxhirit të ftohjes).
- ❑ Ushqimet për ftojje nuk duhet të prekin në serpentinë në faqen e pasme.
- ❑ Ruani lëngjet në enë të myllura.
- ❑ Vendosni ushqimet për ftojje me distancë nga njëratjetra, me qëllim që ajri të mund të qarkullojë mirë.

## Treguesi i statusit



Fig. 222

(1) Temperatura aktuale

(3) Statusi i procesit të shkrirjes

(2) Statusi i alarmit

(4) Statusi i bllokimit të derës

## Shikimi i regjistrimit të temperaturave

Regjistrimi i temperaturave tregon kohëzgjatjen e regjistrimit dhe temperaturën minimale dhe maksimale të matur gjatë kësaj kohe.



Fig. 223

## Rivendosja e regjistrimit të temperaturave




Fig. 224

## Shikimi i historisë së alarmeve




Fig. 225 Shembulli tregon një alarm aktiv, një alarm të pakonfirmuar dhe një alarm të konfirmuar.

- ▷ Historia e alarmeve tregon alarmet aktive, të konfirmuara ose të pakonfirmuara (maksimumi 10 alarme).
- ▷ Fshirja e historisë së alarmeve: Shihni manualin e përdorimit.

## Pastrimi i pajisjes

- Zbrazni pajisjen.
- Hiqni spinën elektrike.
- Ndiqni instrukzionet sipas manualit të përdorimit.
- Pas pastrimit, thani plotësisht pajisjen dhe pjesët e saj.
- Lidhni pajisjen.
- Ndizni pajisjen.
- Mbushni pajisjen kur të jetë arritur temperatura e ruajtjes.



## Çfarë duhet bërë në rast defekti?


Në rast defekti, në ekranin e pajisjes shfaqet një mesazh. Mesazhet kanë kuptime të ndryshme:

Ngjyra e simbolit në ekran	Kuptimi	Zgjidhja e mundshme
<b>E VERDHË</b>	<b>Kujtesë</b> Kujton për proceset e përgjithshme. Ju mund t'i ekzekutoni këto procese dhe kështu të eliminoni mesazhin.	Lexoni në manualin e përdorimit dhe kryeni hapat për zgjidhjen e mundshme.
<b>E KUQE</b>	<b>Paralajmërim</b> Shfaqet në rast problemesh në funksionim. Ju mund t'i eliminoni vetë problemet e thjeshta në funksionim.	Lexoni në manualin e përdorimit dhe kryeni hapat për zgjidhjen e mundshme.

Nëse nuk mund ta eliminoni vetëm problemin, drejtohuni te punonjësi përgjegjës ose te një pikë e kujdesit për klientin.

Pritni faqen





[home.liebherr.com/fridge-manuals](https://home.liebherr.com/fridge-manuals)

 Pajisje ngrirëse

Data e botimit: 20240918

**Indeksi i nr. të  
artikullit: 7083320-00**

Liebherr Hausgeräte Lienz GmbH  
Dr.-Hans-Liebherr-Strasse 1  
A-9900 Lienz  
Österreich

